



Procesi i vetingut dhe pasojat e tij, drejt një sistemi gjyqësor të pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm në Shqipëri

Dokument Qëndrimesh

Shkurt, 2025

Ky publikim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, “Përmirësimi i Debatit mbi Politikën dhe Llogaridhënien për të Përmbytur të Drejtat Bazike, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri”, zbatuar nga katër organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Studimet Politike dhe Instituti Shqiptar i Shkencës, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese.

Hartoi: 1. Blerina Bulica, Eksperte e Jashtme, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rishikoi:

1. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
2. Z. Njazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10,
Tirana-Albania Kutia Postare nr.1752,
Tel: 04 2233671 Mob: 0694075732
E-mail: office@ahc.org.al Website: www.ahc.org.al

Përmbledhje ekzekutive

Procesi i vetingut në kuader të përmbylljes së tij, ka ngritur pikëpyetje në lidhje me matjen e efekteve që ka krijuar në performancën e sistemit të drejtësisë. Ky dokument politikash ofron një analizë të ciklit të procesit të vetingut në përmbyllje pas mbarimit të mandatit kushtetues të KPK-së, sipas gjetjeve nga monitorimet e kryera nga KShH në drejtim të hetimit administrativ, procesit të vendimmarrjes nga ana e organeve të vetingut, mënyrës se si janë garantuar të drejtat e subjekteve të vetingut, si dhe ndjekjes penale të rasteve të subjekteve të shkarkuar. Një vlerë e shtuar në analizën e ofruar në këtë dokument, përbën dhe tryeza e organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkut, me pjesëmarrjen e ambasadorëve të Mbretërisë së Hollandës, Sh.T Z Reinout Vos, Ambasadori i delegacionit të Bashkimit Europian Sh.T.Z Silvio Gonzato, si dhe përfaqësues të lartë të institucioneve të drejtësisë, Z. Ilri Rusi, Kryetar i KLGJ-së, Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i ILD-së, Z. Erion Fejzulla, anëtar i KLP-së, Znj. Evgjeni Bashari, Kryetare e ILDKPI, dhe Z. Arjan Dyrmishi, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për Studime të Demokracisë dhe Qeverisje, të cilët ofruan një kontribut të rëndësishëm në qasjen e problematikave të këtij procesi. Duke mirëkuptuar iniciativën për përgatitjen e këtij dokumenti si një hap i parë për analizën e procesit, KShH dakortësohet me idenë se një analizë më e plotë e procesit të vetingut në një fazë të dytë mund të realizohet nëpërmjet anketimeve dhe matjes së perceptimit të qytetarëve dhe të magjistratëve kundrejt performancës së organeve të vetingut. Kjo analizë e procesit të vetingut është e rëndësishme për të kuptuar dhe efektet që procesi ka pasur në krijimin e vakancave në kushtet kur 47% magjistratëve u larguan nga sistemi, të cilat krijuan vështirësi në shpërndarjen e ngarkesës në gjykata, për shkak të krijimit të backlogut dhe zvarritjeve të gjykimeve. Krahas këtyre vështirësive, ndikim ka pasur zbatimi i hartës së re gjyqësore, që solli shkrirjen e 22 gjykatave të shkallës së parë në vetëm në 13. Për këtë arsye, perceptohet se procesi i vetingut ka krijuar një situatë të re të natyrës “sui generis” në sistemin e drejtësisë, që e ka sfumuar vlerën e tij parësore për ruajtjen e integritetit të sistemit të gjykatave nga magjistratët e papërgjegjshëm. Pavarësisht efekteve anësore, KSHH nënvizon se është e rëndësishme ruajtja e standarteve institucionale të organeve të rivlerësimit, si një zgjidhje e domosdoshme për sistemin e gjykatave, për të forcuar dhe promovuar përgjegjshmërinë e magjistratëve, si dhe për të ofruar adresimin e duhur për ndëshkueshmërinë e magjistratëve që kanë shpërdoruar detyrën. Prandaj, vetingu i magjistratëve duhet të perceptohet si domethënës për krijimin e një kulture të munguar në sistemin e drejtësisë, që ndërlidh në një aksiomë të përbashkët të drejtën e qytetarëve për një sistem drejtësie të pavarur dhe të paanshëm, kundrejt profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së magjistratëve. E ardhmja e këtij procesi vlen të diskutohet vetëm në këtë ekuacion vlerash me interes të lartë publik, për të ruajtur legjitimitetin e tij kushtetues si një proces i përhershëm, që mund të vijojë me anë të institucioneve të KLGJ-së dhe KPK-së, apo me anë të një organi tjetër siç është ILDKPI. Ruajtja e procesit të vetingut të magjistratëve, si

kërkesë e përhershme e institucioneve të drejtësisë, për të garantuar rritjen e besimit të publikut në gjykatat dhe për të ulur riskun e depolitizimit të vendimmarrjes së gjyqtarëve, kërkon një kulturë institucionale të institucioneve përgjegjëse, KLGj dhe KPK për të krijuar një kohezion ndërinstitutional për menaxhimin e një sërë hallkash administrative për verifikimin e subjekteve në të treja kriteret, të pasurisë, figurës dhe profesionalizimit. Në raportin e fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, rekomandohet se Këshillat, ILD dhe ILDKPKI duhet të vazhdojnë më tej përpjekjet për të kryer kontrole të plota të pasurisë dhe aty ku është e aplikueshme, kontrollet e kualifikimit të magjistratëve dhe kandidatëve për magjistratë. Në lidhje me këtë, KSHH inkurajon të gjitha institucionet relevante që të ndajnë informacionin sipas kërkesave të ligjit për të përmbushur kontrollet për tre kriteret në përputhje me standardet e larta të vendosura gjatë procesit të vetingut deri më tani, në mënyrë të veçantë në drejtim të:

- 1. Hetimit administrativ nga institucionet e rivlerësimit:** të vlerësohen për të tre kriteret magjistratët dhe të analizohen përmes metodave uniforme për verifikimin e figurës, pasurisë dhe integritetit për magjistratët. Për vlerësimin profesional të subjekteve, KLGJ dhe KLP inkurajohen për miratimin e udhëzimeve nga ana e dy organeve për të pasur një vlerësim sa më shterrues dhe gjithëpërfshirës të subjekteve për këtë kriter duke adoptuar metodologjinë nëpërmjet Vendimit Nr.21/2019 të KPA, që parashikon aplikimin e disa nën-indikatorëve shtesë. Për këtë qëllim në procesin e vlerësimit etiko-profesional periodik që kryhet nga Këshillat mund të ndihmojnë dhe ankesat e qytetarëve. Ndërkohë është e nevojshme që të përforcohen më tej filtrat e kontrollit të figurës së magjistratëve në mënyrë që të parandalojnë kontakte të papërshtatshme të prokurorëve dhe gjyqtarëve me krimin e organizuar, për lehtësimin/favorizimin e segmenteve të krimit të organizuar. Gjithashtu, vlerësohet ruajtja dhe përforcimi i mëtejshëm i praktikës së denoncimit nga ana e qytetarëve ndaj subjekteve të vetingut, që ndihmuan procesin administrativ të verifikimit të të tre kriterëve.
- 2. Për garantimin e llogaridhënies:** Nisur nga numri relativisht i ulët i procedimeve penale në raport me numrin 268 të subjekteve të vetingut të shkarkuar nga ky proces, për ndjekjen efikase penale të subjekteve të vetingut, inkurajohen institucionet e rivlerësimit në mënyrë të veçantë KPA, po ashtu dhe organet ndihmëse të zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga neni 281 i Kodit të Procedurës Penale, për të bërë kallëzim/referim të menjëhershëm në prokurori, për të gjitha ato raste kur nga rezultatet e hetimit/procedimit të vetingut, zbulohen fakte që përbëjnë elemente të veprave penale. Për këtë qëllim, vlerësohet se është e nevojshme të bëhen rregullimet e duhura në legjislacionin përkatës për të nxitur bashkëpunimin mes ILDKPKI dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, kur të dhënat mund të përbëjnë shkak për fillimin e hetimit disiplinor.

3. Për hetimin dhe ndjekjen penale të subjekteve të vettingut nga Prokuroria e Posaçme dhe Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm, rekomandohen të kryhen hetime të plota dhe efektive për veprat penale në fushën e korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, lehtësimit të veprimtarisë apo lidhjeve dhe angazhimit në veprimtari të krimit të organizuar dhe me organizatat kriminale. Në mënyrë të veçantë, rekomandohet që prokuroritë:

- të bashkërendojnë informacion me të dhënat e institucioneve të rivlerësimit, të dhënat dhe informacionet e organeve ndihmëse si ILDKPKI , apo agjenci të tjera ligj zbatuese si brenda dhe jashtë vendit,
- t'i kushtojnë vëmendjen e duhur fakteve të bëra publike në media gjatë procesit të rivlerësimit, për të filluar hetimin kryesisht (*ex officio*) në të gjitha rastet kur ka indicie publike për kryerjen e një vepre penale,
- të zhvillojnë hetime pasurore sipas ligjit anti-mafia ndaj subjekteve të vettingut, të cilët dyshohen se kanë kryer vepra penale si rrjedhojë e shkeljeve të renda, të konstatuara gjatë procesit të vettingut,
- të përdoren teknika speciale të hetimit konform neneve 221 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale,
- të respektohen afatet e hetimit paraprak, të motivohen vendimet për zgjatje të afateve të hetimit dhe të njoftohen në kohë vendimet për zgjatjen e afatit tek të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre, konform neneve 323 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale.

Këto standarte duhen garantuar si pjesë e procedurave të punës së organeve të qeverisjes së drejtësisë për mbrojtjen e integritetit, pavarësisë, profesionalizmit dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor/atij të prokurorisë, duke respektuar një balancë të kujdesshme, me qëllim që të mos krijojnë më dëme (vakanca) në sistemin e gjykatave. Qëllimi në të ardhmen është që sistemi i drejtësisë të jetë i aftë të ofrojë rehabilitimin e duhur për atë pjesë të magjistratëve që vijon të jetë vulnerabël nga ndikimet e papërshtatshme. Në këtë fazë, ky dokument mund të krijojë një bazë të mirë për institucionet e përfshira në procesin e vettingut për të reflektuar mbi sfidat dhe vështirësitë e hasura dhe për të arritur në konkluzione më të qarta mbi konsolidimin e praktikave më të mira që mund të shërbejnë si orientuese në të ardhmen.

I. Hyrje

Komisioni European në progres raportin për Shqipërinë (2024) ka evidentuar se përgjegjësia e gjyqësorit është kryesisht e kënaqshme dhe kuadri ligjor për llogaridhënien e gjyqtarëve janë plotësisht në përputhje me standardet evropiane. Vlerësohet se ecuria e procesit të rivlerësimit kalimtar (vetting) të gjyqtarëve dhe prokurorëve, e kombinuar me funksionimin e kënaqshëm të KLGJ-së, kanë siguruar një progres të mirë në zbatimin e reformave në drejtësi duke forcuar

përgjegjshmërinë në të gjithë sistemin e drejtësisë. Afër përfundimit, procesi i vetingut mendohet të ketë pasur ndikim të përgjithshëm pozitiv në pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit. Po ashtu, vendimet përfundimtare të procesit të vetingut kanë vendosur standarde të rëndësishme në fushën e kontrollit të figurës, të pasurisë dhe aftësive të magistratëve. Sfida në të ardhmen është që Kolegji i Apelit të rrisë ritmin e shqyrtimit të rasteve në apel për të përmbushur afatin kushtetues, si dhe të përshtatën dhe të ruhen këto standarde gjatë performances së magistratëve¹.

Aktualisht, kur procesi i vetingut deri në përmbylljen e plotë të tij zbatohet nga institucionet e KLGJ-së, KLP-së dhe KPA², rëndësi merr garantimi i vijimit të tij me standarde të përafërta me ato të krijuara nga ana e institucioneve të vetingut nga viti 2018 - 2024. Ky objektivi është pjesë e dokumentave strategjikë si Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë (SND 2024-2030) e cila synon të zbatojë një kuadër ligjor dhe nënligjor për sistemin e drejtësisë në Shqipëri,³ duke siguruar një harmonizim me instrumenta të tjerë strategjikë për integrimin evropian⁴ si dhe me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës⁵ adoptuar nga Ministria e Drejtësisë. Kështu, në kuadër të rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024⁶ pritet që SND të konsolidojë ndryshimet ligjore dhe institucionale për të përmirësuar aksesin në sistemin e drejtësisë dhe për të forcuar njëkohësisht besimin dhe transparencën e publikut. Në zbatim të tyre pritet të merren masa që zgjasin nga viti 2025 deri në vitin 2030 për përmbylljen me sukses të procesit të vetingut, si një garanci për funksionimin e plotë dhe profesional të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Më konkretisht deri në vitin 2030 pritet të konsolidohen rregullimet e duhura ligjore dhe institucionale sa i takon:

- Finalizimit të procesit të rivlerësimit brenda afateve kushtetuese nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA),
- Angazhimit ndërinstitutional dhe forcimit të kapaciteteve për KLGJ dhe KLP për të garantuar qëndrueshmërinë e rivlerësimit të magistratëve deri në përfundimin e plotë të procesit,
- Sigurimit deri në fund të vitit 2025 të burimeve njerëzore të kualifikuara dhe forcimit të kapaciteteve deri në vitin 2026 të ILDKPI, DSIK, SPAK, PP dhe MD për garantimin e standardeve të verifikimit të figurës, pasurisë, dhe integritetit për magistratët por dhe për anëtarët jo magistratë të Këshillave dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- **Vendimmarrjeve mbi zhvillimin e karrierës së magistratëve, bazuar në meritën, profesionalizmin dhe kontrollin e pasurisë dhe figurës së tyre;**

¹ Shih Albania 2024 Report: chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

² Me ndryshimet kushtetuese të miratuara në Kuvend në dt.10 Shkurt 2022

³ Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”; Ligji nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”; Ligji nr. 111, datë 14.12-2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”

⁴ Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian, Planin Kombëtar për Integrim Evropian, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030

⁵ Kapitulli 23: “Gjyqësori dhe të drejtat themelore/Nënkapitulli: Të drejtat themelore”

⁶ Ibid, 3.

- **Rishikimit të rregulloreve të brëndshme për KLGJ, KLP, dhe KPA për vlerësimin në kohë të performancës së magjistratëve, si dhe për një komunikim sa më të mirë publik sipas parimeve të pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies, cilësisë së drejtësisë, efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit;**
- Përditësimin periodik të deklaratave të pasurisë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga ana e KLGJ dhe KLP përmes ILDKPI-së, si dhe ndjekja e hetimeve në prokurori për kallëzimin e atyre rasteve që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal.
- Kryerjes së trajnimeve nga shkolla e Magjistraturës dhe KLGJ për gjyqtarët, prokurorët dhe stafin e gjykatës për të evituar konfliktin e interesit të tyre.

Në këtë kontekst, ky dokument politikash përmban një analizë të procesit të vetingut që prej vitit 2018 - 2022, referuar raporteve të monitorimit që KShH ndaj veprimtarisë së organeve të vetingut KPK dhe KPA, për të ofruar gjetje mbi efektet e procesit të vetingut për forcimin e shtetit të së drejtës, sistemit gjyqësor dhe zbatimit të ligjit. Në lidhje me këtë, qëllimi është të prezantohen rekomandime konkrete mbi standartet që duhet të garantojnë institucionet e rivlerësimit në baza të perhershme dhe koherente, për përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe profesionalizmin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për këtë qëllim, do të prezantohet një analizë mbi bazën e të dhënave sasiore dhe cilësore për:

- Hetimin administrativ si dhe vendimarrjen për konfirmimin apo shkarkimin e magjistratëve, me fokus në vlerësimin e kontrollit të pasurisë, figurës dhe profesionalizmit të magjistratëve,
- Të drejtat e subjekteve të rivlerësimit referuar mbrojtjes që i garanton ligji, sidomos garancive që lidhen me procesin e rregullt ligjor,
- Standartet e transparencës dhe llogaridhënies së procesit të vetingut për ndëshkueshmërinë e magjistratëve të përgjegjshëm.

Mbi bazën e gjetjeve, synohet të orientohen institucionet përgjegjëse për rivlerësimin kalimtar të magjistratëve, KLGJ dhe KLP, si dhe organet ndihmëse mbi praktikën më të mira të procesit të vetingut, në kuadër të përmbushjes së objektivave strategjike të efikasitetit, transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit të magjistratëve.


1. Konteksti i procesit të vetingut

Si një ndër hallkat e reformës në drejtësi, procesi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve i konceptuar fillimisht me natyrë tranzitore dhe i jashtëzakonshëm, ka shërbyer si instrument kushtetues për rikthimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. KShH vlerëson se thyerja e mitit të pandëshkueshmërisë të magjistratëve është një hap i rëndësishëm për fuqizimin e besimit të qytetarëve tek institucionet por edhe si një garanci për demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Në këtë drejtim, standartet e vendosura nga praktika e deritanishme vendimmarrëse e KPK-së si dhe ajo ankimese e KPA garantojnë koherencë dhe qëndrueshmëri të mirë, për subjektet që janë në pritje të

procesit të vettingut.⁷Referuar analizës së vendimarrjeve të përzgjedhura, vlerësohet me nota pozitive fakti se në shumicën e tyre, organet e vettingut kanë respektuar parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë së armëve juridike, të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur të subjekteve, si parime kryesore që duhet të udhëheqin këtë proces.

Në respektim të përparësive për shkak të ligjit, subjektet e para, që iu nënshtruan procesit të vettingut ishin anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, kandidatët për në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.⁸ KPK ka shortuar për herë të parë në datën 01.12.2017 për 57 subjektet e parë dhe seanca e parë dëgjimore për procedurat e rivlerësimit ka filluar në datën 21 Mars 2018. Ndërsa nga të dhënat e siguruara në faqen zyrtare të KPK, procesi i vettingut rezulton të jetë i mirë, ku nga ana e KPK nga data 8 shkurt 2018 deri në datën 30 nëntor 2024 janë dhënë 805 vendime, nga të cilat:

- 373 vendime për konfirmim në detyrë⁹
- 268 vendime për shkarkim nga detyra¹⁰
- 105 vendime për ndërprerje procesi¹¹
- 8 vendime për pushimin e procesit¹²
- 49 vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar¹³
- 2 vendim për pezullimin nga detyra për 2 prokuror.



Nga grafiku mund të konstatohet se numri më i lartë i konfirmimeve në detyrë ka qënë në vitin 2023, pasuar nga viti 2024 dhe viti 2022. Ndërsa numri më i lartë i shkarkimeve nga detyra i subjekteve të rivlerësimit ka qënë në vitin 2021, 2019 dhe vitin 2022. Po ashtu ka pasur një numër

⁷ Ky aspekt është nënvizuar edhe në Opinionin e Komisionit të Venecias për amendamentet Kushtetuese, i cili ka mbështetur zgjatjen e mandatit të organeve të vettingut (KPK dhe KP)

⁸<http://kpk.al/2017/12/12/njoftim/>

⁹Për 165 gjyqtarë, 167 prokurorë, 2 ish-inspektorë në KLD, 2 inspektor në KLGJ dhe 37 ndihmës/këshilltarë ligjorë


¹⁰Për 146 gjyqtarë, 1 ish-gjyqtarë në GJL, 116 prokurorë, 1 inspektor në KLGJ dhe 4 ndihmës ligjorë

¹¹Neni G i Aneksit të Kushtetutës për 61 gjyqtarë, 27 prokurorë, 1 ish-prokuror, 14 ndihmës ligjorë, 1 ish-inspektorë në KLD

¹²Për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmës ligjorë në Gjykatën e Lartë (neni 56 i ligjit nr. 84/2016)

¹³Për 25 gjyqtarë, 1 ish-gjyqtar, 17 prokurorë, 1 ish-kryeinspektor në KLD dhe 2 ish-inspektor në KLD dhe 4 ndihmës ligjor (neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative dhe neni 64 i ligjit nr. 96/2016)

më të lartë të ndërprerjes së procesit për të cilat gjen zbatim neni G i Aneksit të Kushtetutës, krahasuar me përfundimet e procesit pa një vendim përfundimtar për të cilat gjen zbatim neni 95 i KPA, dhe neni 64 i Ligjit Nr.96/2016. Nga monitorimet e pjesshme të KShH-së për numrin e seancave dëgjimore¹⁴ mund të konkludohet se nga data 8 shkurt 2018, kur daton vendimi i parë i KPK-së deri në dhjetor 2024, ritmet e procesit të vetingut kanë qënë relativisht të ngadalta. Sipas të dhënave në vitin 2018 në KPK ka pasur mesatarisht 2 seanca dëgjimore në javë, për vitin 2019 ka pasur mesatarisht deri në 7 seanca dëgjimore në javë, për vitin 2020 ka pasur deri në 4 seanca dëgjimore në javë, dhe për vitin 2021 ka pasur deri në 8 seanca dëgjimore në javë. KPK, si një organ që ka pasur një numër anëtarësh që siguronte formimin e katër trupave gjyquese njëherësh, mund të kishte një produktivitet më të lartë. Ndërsa për KPA rezulton se nga viti 2018 deri në vitin 2025 janë në shqyrtim 417 çështje në juridiksion vlerësimi dhe janë dhënë 307 vendime.



Nga grafiku, sipas të dhënave të marra nga faqja zyrtare e KPA-së, rezulton se janë regjistruar më shumë çështje në vitin 2021, 2020 dhe 2019 dhe janë marrë më shumë vendime në vitin 2024, 2023 dhe 2022. Ndërkohë, deri në tetor të vitit 2024, numëroheshin vetëm 7 raste pezull për shqyrtim para KPK-së dhe 123 raste pezull në shqyrtim para KPA-së.

Gjithsesi, KShH vlerëson se ky proces e përmbush plotësisht qëllimin e tij, vetëm kur vendimet e organeve të vetingut arrijnë të gjejnë adresim të plotë në kuadër të ekzekutimit të tyre, për vendosjen para përgjegjësisë penale të gjithë ato magjistratë për të cilët janë zbuluar fakte serioze lidhur me pasuritë dhe kontaktet me krimin e organizuar, të dënueshme penalisht. Prandaj, vetting vlerësohet se ofron standartet e duhura të procesit ligjor dhe të vendimarrjes në përputhje me Kushtetutën, ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vetëm nëse arrin të përmbushë jo vetëm pastrimin e sistemit nga gjyqtarë dhe prokurorë që gjenden me probleme në drejtim të pasurisë, integritetit dhe aftësive profesionale, por dhe të garantojë ndëshkueshmërinë e tyre si një kërkesë e llogaridhënies së tyre.

2. Sfidat kryesore të procesit të vetingut

Institucionet e vetingut u krijuan për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve me anë të një procesi transformues që zbatohej për herë të parë në vendin tonë, si një masë për të parandaluar

¹⁴ Shih tabela me lart.

korupsionin dhe për të mbrojtur sistemin gjyqësor nga një klimë politike e polarizuar.¹⁵ Krijimi i tyre është mbështetur në amendamentet kushtetuese për reformimin e thellë të sistemit të drejtësisë, si dhe në miratimin e një ligji të posaçëm të vetingut.¹⁶ Aktualisht, procesi i vetingut i ka kaluar institucioneve të KLGJ-së dhe KLP-së, me mbarimin e mandatit të KPK-së në dhjetor 2024, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës. Po sipas këtij neni, rolin e komisionerëve publikë e merr Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ndërkohë, që Kolegji i apelimit vazhdon shqyrtimin e rasteve deri në përfundimin e plotë të mandatit të tij në vitin 2026.

Institucionet e vetingut u krijuan me vështirësi dhe sfida që në procesin për përzgjedhjen e 20% të kandidatëve, ku ONM ka luajtur një rol të rëndësishëm që të përmbusheshin kërkesat e ligjit për të evituar konfliktin e interesit dhe mosjustifikimin e pasurive të tyre. Këto institucione filluan të funksionojnë afro 9 muaj me vonesë nga mandatimi i tyre, vetëm në 21 Mars 2018,¹⁷ pasi Gjykata Kushtetuese konfirmoi më parë kushtetutshmërinë e Ligjit Nr.84/2016 “Për vetingun”.¹⁸ Nga pikëpamja e organizimit të këtyre institucioneve, ka pasur vonesa në akomodimin e anëtarëve në godinat përkatëse, në pajisjen e tyre me personel mbështetës,¹⁹ në klasifikimin e pagave të personelit, si dhe në miratimin e buxhetit të tyre.²⁰ Për zbatimin e Ligjit Nr.84/2016, veprimtaria e KPK dhe KPA është ndikuar nga nevoja për të bashkëpunuar me organet e tjera ndihmëse, përfshirë Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD), Prokurorinë e Përgjithshme (PP), Inspektoriatin e Lartë të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPI), si dhe Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSKI). Të gjithë këto faktorë të marrë së bashku, ndikuan që procesi i vetingut në fillimet e veta të kishte një ecuri relativisht të ngadaltë, që ishte kritike për të marrë konfirmimin e kandidatëve për anëtarë për krijimin e institucioneve të reja të KLGJ-së dhe KLP-së, para se ato të votoheshin nga Kuvendi. Veçanërisht domethënës procesi i vetingut ka qënë për konfirmimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED),²¹ funksionimi i të cilit ishte parakusht për renditjen e kandidatëve në Gjykatën Kushtetuese dhe në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë,²² por sidomos për Gjykatën e Lartë. Për shkak të shkarkimit të gjyqtarëve nga procesi i vetingut në gjykatat më të larta, u krijuan vështirësi në plotësimin e trupave gjyqësore. Kështu, Gjykata e Lartë në vitin 2016 kishte mbetur me vetëm 3 gjyqtarë dhe numëronte 32,000 çështje të mbartura, në vitin 2020 numëronte 36,000 çështje të mbartura dhe në vitin 2024 numri i çështjeve të backlogut është ulur ndjeshëm në 18,000 çështje të mbartura. Në datë 10.02.2022, Kuvendi miratoi ndryshimet kushtetuese që mundësojnë zgjatjen me dy vite e gjysëm të mandatit të Komisionerëve Publik (KP) dhe anëtarëve të KPK-së, përkatësisht, deri në datë 31 Dhjetor të vitit 2024. Me mbarimin e këtij afati, roli i KPK për shqyrtimin e rasteve të mbetura i kalon Këshillave, ndërkohë KPA e përmbyll mandatin e saj në vitin 2026.

¹⁵ Ligji nr.84/2016 për rivlerësimin kalimtar të magjistratëve.

¹⁶ Ligji nr.84/2016 për rivlerësimin kalimtar të magjistratëve.

¹⁷ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Komisionerët Publikë (KP) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA)

¹⁸ Vendim Nr. 2 datë 18.01.2017, i Gjykatës Kushtetuese të RSh-së.

¹⁹ Kuvendi miratoi Vendimin “Për miratimin e blloklistës së kandidatëve të përzgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr.84/2016”

²⁰ Vendimet nr. 92, 93 dhe 94/ 2017 të Kuvendit.

²¹ Ndërkohë që për vitin 2024 ka pasur rreth 32 gjyqtarë të rinj, në vitin 2025 pritet të ketë 45 gjyqtarë të rinj, ndërsa në 2026 do të ketë 20 gjyqtarë të rinj.

²² Ndërkohë që për vitin 2024 ka pasur rreth 32 gjyqtarë të rinj, në vitin 2025 pritet të ketë 45 gjyqtarë të rinj, ndërsa në 2026 do të ketë 20 gjyqtarë të rinj.

Aktualisht, janë 268 magjistratë të cilët janë gjetur me shkelje dhe rrjedhimisht janë larguar nga sistemi, duke krijuar një numër të lartë vakancash të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në vitin 2023, KLGJ ka raportuar se sistemi i gjykatave ka funksionuar me 247 gjyqtarë efektivisht në detyrë, nga 408 gjyqtarë që përcakton struktura organizative (organika në fakt 329 gjyqtarë). Po ashtu rezulton tejet problematike numri i vakancave të gjyqtarëve në gjykatat, ku në gjykatat e rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm ka pasur mungesë 44% të gjyqtarëve; në Gjykatën Administrative të Apelit ka pasur mungesë të gjyqtarëve në masën e 57% të stafit gjyqësor; në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka pasur mungesë të gjyqtarëve në masën 31% të stafit gjyqësor (24 nga 78 gjyqtarë); dhe në Gjykatën e posaçme të shkallës së parë ka pasur mungesë të gjyqtarëve në masën e 56 % të stafit gjyqësor. Si pasojë e krijimit të vakancave në sistemin e gjykatave, vetingu i magjistratëve solli efekte të dukshme në krijimin e një numri të lartë të çështjeve të mbartura në gjykatat, në zvarritjen e gjykimeve, në mënyrën e zbatimit të skemës së karrierës së magjistratëve, e cila duhej mbi të gjitha të shërbente për plotësimin e trupave gjykues. Përveç vakancave të krijuara nga procesi i vetingut, një faktor tjetër në shpërndarjen e ngarkesës së gjykatave me numër të lartë çështjesh, ka qënë dhe ndikimi i zbatimit të hartës së re gjyqësore. Si rezultat i shkrirjes së 9 gjykatave, ka pasur bashkim të stafit gjyqësor dhe administrativ në gjykatat e shkallës së parë Dibrë, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm (për shkak të shkrirjes së 6 gjykatave të apelit), dhe në gjykatën administrative Tiranë dhe Lushnjë. Rezulton se përveç gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë që ka një përqindje 62 % të gjyqtarëve në detyrë, aktualisht të gjitha gjykatat e tjera kanë një përqindje shumë të ulët të gjyqtarëve në detyrë. Ndërkohë hapja e vendeve vakante për gjyqtarë është e lartë në të gjitha gjykatat, dhe shumë e lartë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Për plotësimin e vakancave në sistem, KLGJ ka marrë disa masa si:

- Rritjen e kuotave dhe rekrutimin e magjistratëve kandidatë të diplomuar nga ShM (40 në vitin akademik 2022-2023),²³
- Menaxhimin efikas të nëpunësve gjyqësorë civilë,
- Kryerjes së transferimeve²⁴ dhe delegimeve, ngritjes në detyrë²⁵, lëvizjes paralele për 11 gjyqtarë, si dhe nëpërmjet caktimit të 208 gjyqtarëve në çështje të tjera.²⁶

KLGJ ka vendosur objektiva strategjike për periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2027, për të rritur numrin e gjyqtarëve respektivisht, në 70 gjyqtarë për gjykatën e shkallës së parë në Tiranë, në 60-78 gjyqtarë për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, dhe në 27 gjyqtarë për gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë.²⁷ Pavarësisht këtyre sfidave, procesi i vetingut mendohet se

²³ Ndërkohë që për vitin 2024 ka pasur rreth 32 gjyqtarë të rinj, në vitin 2025 pritet të ketë 45 gjyqtarë të rinj, ndërsa në 2026 do të ketë 20 gjyqtarë të rinj.

²⁸Neni 49 i ligjit nr.84/2016 që parashikon “Mjetet e kërimit të provës” parashikon mundësi për të kërkuar dhe marrë prova të ndryshme nga organet ndihmëse.

²⁸Neni 49 i ligjit nr.84/2016 që parashikon “Mjetet e kërimit të provës” parashikon mundësi për të kërkuar dhe marrë prova të ndryshme nga organet ndihmëse.

²⁸Neni 49 i ligjit nr.84/2016 që parashikon “Mjetet e kërimit të provës” parashikon mundësi për të kërkuar dhe marrë prova të ndryshme nga organet ndihmëse.

²⁸Neni 49 i ligjit nr.84/2016 që parashikon “Mjetet e kërimit të provës” parashikon mundësi për të kërkuar dhe marrë prova të ndryshme nga organet ndihmëse.

është një kërkesë e domosdoshme për forcimin e kulturës institucionale të përgjegjshmërisë dhe ndëshkueshmërisë së magjistratëve.

ILDKPI si një institucion kyç për verifikimin e pasurisë së magjistratëve, ka raportuar se ka kryer rreth 3000 verifikime për subjekte të vetingut si dhe personave të lidhur me to. Nisur nga ky volum i lartë, lind nevoja për një ndërveprim dhe koordinim sa me efikas në mes organeve ndihmëse ILDKPI, PP, DSKI, ILD si faktorë të rëndësishëm të procesit gjatë hetimit administrativ në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e rivlerësimit. Përveç nevojës për një ndarje të qartë të roleve në mes këtyre institucioneve, gjithashtu është e rëndësishme të realizohet dhe matja e performancës së tyre mbi bazë të indikatorëve të efikasitetit dhe produktivitetit. Po ashtu, kërkohet një bashkëveprim me këshillat e gjykatave, apo zyrat e prokurorive të cilët transferojnë një numër të lartë dosjesh për magjistratët që janë në proces vetingu tek KLGJ dhe KPK. Disa hapa pozitivë drejt koordinimit mes institucioneve të KLGJ-së dhe KPK-së është krijimi i një grupi teknik pune që menaxhon koordinimin e procesit të rivlerësimit, ndërkohë një draft rregullore është hartuar mbi procedurat që duhen ndjekur këtej e tutje nga këto dy institucione për përmbylljen e procesit të vetingut.

V. Standartet e procesit të vetingut sipas gjetjeve të KShH-së për periudhën 2018-2022

Në kuadër të gjetjeve të bëra nga monitorimet e vazhdueshme të kryera nga ana e KShH-së të shtrira në kohë përgjatë viteve 2017 deri në vitin 2022, për qëllimet e analizës së këtij raporti vlen të evidentohen disa aspekte, si: (1) organet ndihmëse të vetingut, (2) Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM), (3) hetimi administrativ i organeve të vetingut sipas tre kritereve, (4) vendimarrja e organeve të vetingut KPK dhe KPA, si dhe (5) dorëheqja e subjekteve.

1. Organet ndihmëse të vetingut

Sipas Ligjit të vetingut nr.84/2016, organet e rivlerësimit hetojnë, shqyrtojnë dhe vlerësojnë të dhënat e përfituara nga raportet e organeve ndihmëse me të gjitha provat, faktet dhe dokumentet në dispozicion gjatë këtij hetimi.²⁸ Procesi i vetingut është ndikuar nga veprimtaria e organeve të ndryshme ndihmëse, duke përfshirë ish-KLD-në, PP, ILDKPI-në, DSIK, KLGJ dhe KLP për të arritur në provueshmërinë e rasteve në shqyrtim. Vlen të theksohet se organet e KPK-së dhe KPA-së kanë kryer një hetim të paanshëm dhe të pavarur administrativ sidomos për kriterin e pasurisë, me qëllim që të verifikoheshin deklaratat periodike të kryera nga subjektet në vitet e mëparshme,²⁹ apo për të evidentuar rastet kur subjektet kanë në pronësi pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Më konkretisht:

- **ILDKPI:** Sipas gjetjeve të KShH-së, rezulton se pranë ILDKPKI-së kanë dorëzuar deklaratën e pasurisë në total 794 subjekte të procesit të rivlerësimit.³⁰ ILDKPKI-ja, bazuar

²⁸Neni 49 i ligjit nr.84/2016 që parashikon “Mjetet e kërkimit të provës” parashikon mundësi për të kërkuar dhe marrë prova të ndryshme nga organet ndihmëse.

²⁹Në zbatim të Kushtetutës, në nenin Ç, pika 4 dhe nenin D të Aneksit të saj, ashtu si dhe në ligjin nr. 84/2016, në nenet 30, 32 dhe 33 të tij

³⁰7 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe 9 këshilltarë ligjorë pranë saj; 15 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe 20 ndihmës ligjorë pranë saj; 373 janë gjyqtarë të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit; 27 janë ndihmës ligjorë pranë gjykatave administrative; 326 janë prokurorë pranë

në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin për vetëingun.³¹ Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, për qëllimet e rivlerësimit, mund të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar brenda ose jashtë vendit.³² Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara KPK-së ose Kolegjit të Apelit. ILDKPKI-ja ka mundur akses të plotë për vëzhguesit ndërkombëtarë, që të kërkojnë informacione, të konsultojnë, të kopjojnë dhe të hetojnë deklaratimet e pasurive të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur me të, si dhe dokumentet shoqëruese. Koha që i është dashur ILDKPKI-së për një kontroll të plotë është 180 ditë nga dita e depozitimit të deklaratës së pasurisë. Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së i dërgon organeve të rivlerësimit një raport të hollësishëm.³³ Duhet theksuar se kontrolli i këtij institucioni është paraprak dhe i mbështetur vetëm në dokumentacionin e deklaruar nga subjektet e vetëingut sipas kërkesave të ligjit. Si të tilla raportet e ILDKPKI-së nuk mund të konsiderohen ezauruese për vlerësimin e kriterit të pasurisë, por kanë peshën kryesore në vendimarrjen e institucioneve të rivlerësimit për këtë kriter, krahas një sërë verifikimesh të tjera që ato kryejnë për një hetim të thelluar administrativ. Kështu, gjatë hetimit, organet e vetëingut sigurojnë prova dhe të dhëna mbështetëse të siguruar nga vëzhguesit e ONM-së, nga deklaratimet e vetë subjekteve gjatë seancës, nga deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve etj. Po ashtu, ato mbështeten për verifikimin e tyre dhe në të dhënat e siguruar nga disa institucione sipas parashikimeve të nenit 42 dhe 50 të ligjit për vetëingun.³⁴ Nga të dhënat e administruara pranë ILDKPKI rezultojnë se Inspektorati i Lartë ka dërguar në organet e vetëingut rreth 57% raporte për subjekte me probleme në deklaratën e pasurisë, nga të cilët në 45% të rasteve raportet janë lënë në fuqi nga KPK. Vlen të theksohet se për rreth 25 % të rasteve të raportuara nga ILDKPKI, subjektet kanë ndërprerë procesin, ndërsa për rreth 30% të raporteve të raportuara nga ILDKPKI për kriterin e pasurisë së subjekteve KPK ka vendosur ndryshe. Një rol tjetër i këtij institucioni lidhet dhe me referimin e çështjeve në pokurori. Ky institucion, fillimisht mjaftohej vetëm me referimin e informacionit pranë KPK ose KPA për subjektet e

Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë për Krimet e Rënda, Prokurorive të rretheve gjyqësore dhe apelit; 7 janë ndihmës ligjorë; 10 janë Kryeinspektorë dhe inspektorë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

³¹ Si dhe ligjin “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative

³² Ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta.

³³ Ku konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti i interesit; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehtë e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë;

³⁴ Pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 148, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në të dhënat për gjendjen gjyqësore të subjekteve të rivlerësimit; në dosjet personale të subjekteve të rivlerësimit, të dhënat statistikore, dokumentet ligjore, dosjet e zgjedhura për vlerësim, vetëvlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat mbi trajnimet, mbi ankesat ndaj personave që i nënshtrohen vlerësimit dhe rezultatet e verifikimit ankesave, si dhe mbi vendimet për masat disiplinore ndaj të vlerësuarve; në të dhënat mbi pasuritë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme regjistri noterial shqiptar; në llogaritë bankare, të dhënat tatimore, bazat e të dhënave mbi automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi; në të dhënat mbi të drejta ose interesa pasurorë të çdo lloji mbi një aset, duke përfshirë, kreditë, çeqet e udhëtimit, çeqet bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit, si dhe çdo interes, dividend, e ardhur ose vlerë tjetër që buron prej tyre; në të dhënat mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, në të dhënat që provojnë ekzistencën e parave fizike ose mjeteve ose instrumenteve të tjera të tregut të parës, si dhe të dhënat që provojnë ekzistencën e trusteve ose marrëveshjeve të tjera të ngjashme.

rivlerësimit për kriterin e pasurisë. Në vitet e fundit, vihet re një bashkëpunim i këtij institucioni me SPAK për referimin e rasteve për ndjekje penale, kur hasen probleme me deklarimin e pasurisë që përbëjnë vepër penale. Në këtë fazë të procesit, kur rolin e organeve të vetingut e kanë marrë KLGJ dhe KLP, është e rëndësishme bashkëpunimi i ILDKPI si gjatë fazës së hetimit administrativ dhe pas marrjes së vendimeve përfundimtare me shkarkim të subjekteve, të referojë rastet për ndjekje penale sa herë që plotësohen kushtet sipas kërkesave të ligjit penal.

- **Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK):** Sipas monitorimeve të KShH rezultojnë se numri i subjekteve që e kanë plotësuar Deklaratën për Kontrollin e Figurës është 801, ku 3%³⁵ e kanë plotësuar me mangësi për shkak të dorëheqjes së disa subjekteve. Kjo mospërputhje në numrin e subjekteve që përmbushin formularët e vetë deklarimit vjen edhe për shkak të paqartësive në kategorizimin e gjyqtarëve apo prokurorëve që kanë kërkuar pezullim të përkohshëm dhe janë komanduar në pozicione të tjera në institucionet e drejtësisë, si p.sh. gjyqtarë që janë komanduar si ndihmës ligjorë në Gjykatën e Lartë, Inspektoratin e KLD-së, etj. Ndërsa, për subjektet e kontrolluara nga DSIK ka pasur rreth 25% të rasteve të raportuara nga ky institucion që më pas janë gjetur me parregullsi nga KPK sa i takon figurës së tyre, kryesisht për shkak të takimeve, shkëmbimit të korrespondencës elektronike apo në çdo lloj forme tjetër që sipas ligjit të vetingut konsiderohet e papërshtatshme. DSIK ka të drejtë të caktojë një personel shtesë, për të kryer kontrollin e figurës për qëllim të këtij procesi. Kështu, DSIK bashkë me Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimin e Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, krijojnë një grup pune³⁶ për të përgatitur raportet për efekt të procesit të vetingut. Me kërkesë të grupit të punës ose të institucioneve të rivlerësimit, DSIK mund të komunikojë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar si të tillë.
- **Prokuroria e Përgjithshme (PP):** Prokuroria e Përgjithshme ka raportuar se brenda afatit 31 Janar 2017³⁷ numri total i subjekteve që kanë paraqitur formularin e vetë-deklarimit profesional është 336. Nga gjetjet e KShH-së është konstatuar se PP nuk ka disponuar në raportet e tyre me konkluzione ose vlerësime paraprake por janë mjaftuar vetëm në ofrimin e informacioneve të kërkuara pa i ofruar një analizë të thelluar.

³⁵Pranë DSIK-së kanë dorëzuar deklaratën brenda afatit ligjor 7 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, 6 ndihmës ligjorë dhe 3 këshilltar pranë saj, 17 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe 16 ndihmës ligjorë pranë saj, 73 gjyqtarë dhe 1 prokuror pranë Gjykatave të Apelit, 244 gjyqtarë dhe 6 ndihmës ligjorë pranë gjykatave të shkallës së parë, 39 gjyqtarë, 1 këshilltar dhe 21 ndihmës ligjorë pranë gjykatave administrative dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, 22 gjyqtarë të Gjykatave të Krimeve të Rënda, 1 gjyqtar dhe 10 inspektorë pranë KLD-së 331 prokurorë dhe 2 ndihmës ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorëve të rretheve gjyqësore, si dhe 1 Avokat Shteti

³⁶Me detyra për a) verifikimi i saktë i identitetit në të shkuarën dhe të tashmen, për çdo individ; b) verifikimi nëse ka tendenca kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar; 16 c) vlerësimi i përgjithshëm, nëse individ mund të vihet nën presion nga struktura kriminale; ç) kontrolli nëse ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale;

³⁷Nga të cilët, 326 prokurorë, 7 ndihmës ligjorë dhe 3 ish prokurorë që aktualisht janë në pozicionin e Inspektorit në Drejtorinë e Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë

- **Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP):** ka bashkëpunuar me organet e vettingut për të ofruar raporte për vlerësimin e aftësisë për prokurorët sa i takon aftësisë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Aktualisht, me mbarimin e mandatit nga ana e KPK-së, KLP vepron si organ i rivlerësimit kalimtar për subjektet e vettingut nga rradha e prokurorëve, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës.
- **Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ):** Fillimisht, në organet e vettingut ka raportuar inspektorati i ish-KLD-së mbi regjistrimin e 250 subjekteve për verifikim.³⁸ Më tej, këtë rol e ka marrë Këshilli i Lartë Gjyqësor për dërgimin e raporteve të vlerësimit mbi aftësinë e gjyqtarëve, këshilltarëve ligjorë ose ndihmësve ligjorë mbi aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Aktualisht, me mbarimin e mandati nga ana e KPK-së, KLGJ vepron si organ i rivlerësimit kalimtar për subjektet e vettingut nga rradha e gjyqtarëve, dhe ndihmësve ligjorë bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës.
- **Shkolla e Magjistraturës (SheM):** Vlerësimi i aftësisë për këshilltarët ose ndihmësit ligjorë përfshin testimin pranë Shkollës së Magjistraturës, për rrjedhojë organet e vettingut kanë bashkëpunuar me këtë institucion për hetimin e kësaj kategorie.
- **Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD):** Subjektet që kalojnë me sukses rivlerësimin, i nënshtrohen sistemit të përhershëm të llogaridhënies, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj. Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, organet e rivlerësimit kanë të drejtën të transferojnë çështjen pranë ILD për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore,³⁹ ose shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi si rregull nuk mund të bëhet ankim, dhe në raste të tilla ILD fillon menjëherë shqyrtimin e shkaqeve.⁴⁰ Inspektori i Lartë i Drejtësisë, evidenton raste me elemente të dukshëm të veprave penale të kryera nga ana e subjekteve të rivlerësimit, të cilat duhet ti nënshtrohen ndjekjes penale nga ana e organit të prokurorisë. Prandaj kërkohet më shumë bashkëpunim në të ardhmen ndërmjet institucioneve të rivlerësimit, KLGJ dhe KLP me ILD dhe organin e prokurorisë për të hetuar dhe ndjekur penalisht subjekte të kësaj kategorie.
- **Struktura e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK):** Aktualisht, me mbarimin e mandatit të KPK-së në dhjetor 2024, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, rolin e komisionerëve publikë e merr Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Për

³⁸Janë paraqitur në Inspektorat kopje të 198 dosje gjyqësore, të cilat lidhen me rivlerësimin kalimtar të 40 subjekteve të rivlerësimit; për 10 subjekte rivlerësimi, Inspektoriati është në pritje të dosjeve; për 12 subjekte rivlerësimi janë paraqitur të gjitha dosjet dhe po punohet për finalizimin e raporteve sipas formës standard, me qëllim dërgimin e tyre sa më shpejt pranë KPK-së; për 28 subjekte rivlerësimi, janë paraqitur të gjitha dosjet dhe është përfunduar analiza e tyre.

³⁹Sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve

⁴⁰ Neni 59 I ligjit për vettingun.

rrjedhojë, ai shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Drejtuesi i SPAK mund të ushtrojë ankim ndaj vendimeve të KLGJ-së dhe KLP-së për subjektin e rivlerësimit pranë KPA-së. Në këtë rast, KPA nuk mund të vendosë një masë disiplinore më të rëndë, pa i dhënë subjektit të rivlerësimit kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për t'u dëgjuar në seancë. Një rol tjetër i rëndësishëm i SPAK është të vijojë hetimin e subjekteve të rivlerësimit të shkarkuar nga vetingu, duke ndërmarrë veprime qoftë dhe me iniciativën e tij. Në këtë drejtim ka pasur mungesë të theksuar të bashkëpunimit të organeve me SPAK për të referuar kallëzime penale konkrete pranë këtij organi. Në lidhje me këtë, dispozitat kushtetuese apo ligjet në fuqi⁴¹ kanë nevojë për plotësime për të parashikuar sesi veprohet kur nga hetimi administrativ kanë dalë prova që plotësojnë elementet e veprës penale. Gjithashtu, në këto parashikime duhet të gjejë përcaktim dhe cili institucion ka të drejtë të referojë në organin e akuzës këto raste për hetime të mëtejshme. Këto mungesa ligjore e rëndojnë dyfish rolin e Drejtuesit të SPAK, nisur nga fakti se merr kompetencat e parashikuara në Kushtetutë për Komisionerin Publik.

- **Gjykatat dhe Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm**, duhet të tregojnë një gatishmëri më të madhe për të ndjekur qoftë nëpërmjet kallëzimeve penale, qoftë me iniciativën e tyre, rastet kur shkarkimi nga detyra i subjekteve të rivlerësimit kalimtar kanë qenë për shkaqe që përmbajnë dyshime të arsyeshme për konsumim të veprës penale. Gjykatat dhe Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bazë të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale për të gjitha ato vepra penale dhe subjekte të rivlerësimit kalimtar të shkarkuar nga organet e “vetting-ut”, për të cilët nuk vepron Gjykata e Posaçme.⁴² Që nga viti 2018 dhe deri në korrik 2022, rezulton se gjykatat dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm nuk kanë të dhëna statistikore për hetime, gjykime apo dënime për subjektet e vetingut. Shqetësuese është dhe parashkrimi i afateve të hetimit apo gjykimit të veprave penale të deklarimit të rremë apo fshehje të burimeve financiare për shkak të vonesave në denoncimin për subjektet e rivlerësimit kalimtar të shkarkuar duke lënë subjektet e vetingut jashtë përgjegjësisë penale.

2. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

Fakti që pranë ONM-së u emëruan vëzhgues nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në sistemin e drejtësisë së vendeve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, ishte një garanci pozitive në procesin e mbikqyrjes së vettingut dhe orientimit të tij drejt standarteve më të mira të kontrollit dhe llogaridhënies. Gjithsesi, roli i ONM-së është kufizuar shprehimisht në ushtrimin e kompetencave me natyrë monitoruese, pa asnjë rol vendimarrës apo të

⁴¹ Ligji për vetingun

⁴² Neni 135/2 Kushtetuta e Republikë, Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

lidhur me administrimin e procesit të vettingut. Pavarësisht mandatit të ONM-së, vëzhguesit e tyre kanë ofruar informacion vetëm për sa është dhënë në seancë dëgjimore për opinionin e gjërë publik. Ndërkohë që ato kanë luajtur një rol gjatë procesit të shqyrtimit, për të kontrolluar dosjet, për të pasur akses në informacionin në dispozicion, për të rekomanduar marrjen e provave shitesë apo ushtrimin e të drejtës së ankimit nga ana e komisionerëve publikë, qëndrimet e ONM-së për çështjen nuk kanë gjetur gjithmonë reflektim në vendimet e arsyetuara të organeve të vettingut. Në raste sporadike, roli dhe kontributi i ONM-së ka çuar në rihapjen e shqyrtimit gjyqësor.⁴³ Po ashtu ka pasur raste kur opinioni dhe gjetjet e vëzhguesit të ONM janë mbështetur tek denoncimet e publikut.

3. Hetimi administrativ i organeve të vettingut

Sipas monitorimit nga KShH, hetimi administrativ nuk ka rezultuar gjithëpërfshirës, i unifikuar dhe nuk ka garantuar barazi midis subjekteve bazuar mbi vlerësimin e të tre kriterëve (pasuria, figura dhe aftësitë profesionale).⁴⁴ Fillimisht diktuar nga nevoja për ritme më dinamike në vendimarrjen e KPK dhe KPA subjektet janë vlerësuar bazuar vetëm në një kriter⁴⁵, por më vonë progresivisht me kalimin e viteve subjektet janë vlerësuar në dy kriterë, deri tek vlerësimi për të tre kriteret.⁴⁶ Në një rast KPK ka referuar si “hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm” si përmbushje të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për vlerësimin vetëm të kriterit të pasurisë. Në fakt, sipas këtij neni nënkuptohet vlerësimi i të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit bazuar në të treja kriteret, dhe jo vetëm në një kriter.⁴⁷ Ndërsa KPA në Vendimin 23/2019 është shprehur se është në diskrecionin e organeve të vettingut KPK dhe KPA, si institucionet përgjegjëse, për të vendosur për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në një, në disa ose në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve. Në tabelën më poshtë evidentohen disa nga shkeljet më tipike për vlerësimin e tre kriterëve, sipas gjetjeve të KShH-së:

Shkeljet tipike për kriterin e pasurisë	Shkeljet tipike për kriterin e Figurës	Shkeljet tipike për kriterin e Aftësisë Profesionale
Mungesa e deklarimit të një depozite bankare nga personi i lidhur vlerësohet mangësi në deklaram ⁴⁸	Konflikt interesi i subjektit me shtetas ndaj të cilëve janë ngritur akuza penale si pastrim i produkteve të veprës penale (neni 287 i KP), ndërtim i paligjshëm (neni	Mangësi në njohuritë ligjore, aftësitë e interpretimit dhe respektimit të ligjit

⁴³Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 117 datë 21.03.2019

⁴⁴Konform aneksi Ç i Kushtetutës

⁴⁵Shih vendimet nr. 12, dt. 23.03.2018 dhe nr. 14, dt. 13.04.2018, nr. 15, datë 20.04.2018.

⁴⁶Mbështetur nga organet e vettingut në nenin 4, pika 2 të ligjit nr.84/2016

⁴⁷Shih tabela nr.18 ne aneks

⁴⁸Në rastin e subjektit D.P

	199/a i KP), etj	
Pasaktësi' në deklarin periodik <i>pranë ILDKPKI</i> që është korigjuar më pas (<i>përpara plotësimit të deklaratës vetting</i>), për faktin se ky korigjim është kryer me iniciativën e subjektit të rivlerësimit	Dyshimet bazuar në të dhënat e besueshme për përfshirjen e subjektit në veprën penale të korrupsionit pasiv	Mangësi në arsyetimin ligjor
Mënyrën e plotësimit të deklaratës vetting për burimin e krijimit të pasurisë në rastin kur në deklaratat vjetore është treguar burim i ndryshëm	Përdorimi i automjetit të shtetasit të dënuar për “trafik lëndësh narkotike” në Greqi, etj	Mangësi në cilësitë etike, angazhimin profesional dhe aftësitë organizative
Provueshmëria e pagesës së detyrimeve financiare të subjekteve të rivlerësimit, ose pasaktësitë në deklarinimet e detyrimeve ndaj të tretëve në rastin e subjektit ⁴⁹		Zvarritje apo vonesa në ndjekjen e detyrave (funksionit)
Mungesë përputhshmërie në raportimin e pasurisë dhe burimit të krijimit të saj, midis të dhënave të pasqyruara në deklaratat periodike vjetore pranë ILDKPKI-së me ato të raportuara nga subjekti në deklaratën “vetting”,		Zgjidhje jo të drejtë ndaj praktikave të ndryshme
Pretendimet për standarte të dyfishta		Ka marrë masë disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit
Burim i paligjshëm i të ardhurave		Konflikt interesi apo premisa për njëanshmëri me subjektet në çështjet e hetuara/gjykuara
Fshehje e të ardhurave apo shpenzimeve		
Mosdeklarim i burimit të fitimit të pasurisë, përdorim i dokumentave jo të rregullta për ta provuar atë, deklarim i rremë ose mosjustifikim i të ardhurave		

⁴⁹ Shih tabelën 4 në aneks

për fitimin e pasurisë së subjektit apo personave të lidhur me të		
Mosrespektim i legjislacionit për regjistrimin e pasurisë së luajtshme/të paluajtshme		
Çmimi i blerjes së apartamentit është më i ulët se çmimi i tregut ose kontrata fiktive dhe blerje me çmim fiktiv		
Të ardhurat e përfituara nga emigracioni, janë të pamjaftueshme për të justifikuar shpenzimet		
Përfitim i statusit si i pastrehë, në kundërshtim me ligjin ose në mënyrë të pajustificuar		
Mosdeklarim periodik mbi huanë		
Mosderdhja në mënyrë të plotë e sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat personale		
Pamundësi në likuiditete		

- **Riçelja e hetimit**

Procedura e riçeljes së hetimit administrativ gjatë shqyrtimit në KPK argumentohet kryesisht me dhënien e mundësisë ndaj subjektit të rivlerësimit për të siguruar provat dhe aktet që justifikojnë pretendimet dhe gjetjet e KPK-së, në rastin e kalimit të barrës së provës tek subjekti. Ky mjet ka rezultuar veçanërisht i rëndësishëm për disa subjekte, që kanë pasur një eksperiencë të gjatë pune e për rrjedhojë kanë hasur vështirësi në sigurimin brenda një kohe të shkurtër, të dokumentave që datojnë 20-30 vite më parë.

a. Kriteri i pasurisë

Sipas gjetjeve, kriteri i pasurisë ka shërbyer si kriter përcaktues primar në pjesën më të madhe të hetimit në vendimarrjet e KPK-së dhe KPA-së. Hetimi administrativ bazohet kryesisht në vërtetësinë e deklaratave vjetore të subjekteve, deklaratën veting dhe dokumentet justifikuese që mbështesin këto deklarata. Këto institucione kanë verifikuar se si subjektet dhe personat e lidhur kanë përmbushur detyrimet, nëse burimi i të ardhurave ka qënë i ligjshëm, nëse ka pasur fshehje të pasurisë, apo konflikt të interesit, etj. Nga praktika e vendimarrjes së organeve të vetingut në mbështetjen e konfirmimit apo shkarkimit të subjekteve, ka lindur si debat cili burim ligjor do të kishte rëndësi primare për mbështetjen e pasurisë së subjekteve. Për këtë çështje ka pasur një vendim të KPA-së ku argumentohet se dispozitat kushtetuese nuk kanë si qëllim të përcaktojnë rendin e rëndësisë së deklarimeve, ndaj argumenti mbi vlerën primare të deklaratës së pasurisë

(vetting) nga ajo e deklarimeve periodike të pasurisë në vite nuk përbën një shkak për interpretim nga pikëpamja e anës formale.⁵⁰

Lidhur me burimin e ligjshëm të pasurisë dhe vendin që zë deklarata vetting në raport me deklaratimet periodike të pasurisë ndër vite, KPA ka arsyetuar se “saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur janë elementë përcaktues për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore të posaçme për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.⁵¹

Në vëmendje të analizës së ofruar nga KShH në të gjitha raportet e monitorimit të procesit të vettingut nga viti 2018 deri në vitin 2022 në lidhje me vlerësimin e pasurisë nga ana e organeve të vettingut, janë evidentuar si çështje, të cilat mund të shërbejnë për përmirësimin e mëtejshëm të standarteve, si më poshtë:

- KPK dhe KPA nuk kanë mbajtur të njëjtin qëndrim në vendimarrjen e tyre në lidhje me të ardhurat që kanë deklaruar subjektet para fillimit të detyrës, apo në lidhje me përmbushjen e detyrimeve tatimore për periudha kur ka kaluar një kohë e gjatë. Për arsyetimin ligjor të këtyre shkaqeve KPK është bazuar në dispozitat ligjore (neni 32, pika 2 e ligjit nr.84/2016) që parashikojnë pamundësinë objektive të subjektit për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive. Nga praktika për shëmbull janë evidentuar si shkaqe mungesat në dokumentacion dhe dëshmi për aktivitete para 20 vjetësh, pamundësitë për ruajtjen e faturave për shkak të ndryshimeve në ligjet fiskale dhe financiare, vështirësitë në vërtetimin e metodave të marrjes së pasurisë, veçanërisht ato të siguruara para vitit 2003.⁵² Gjithësesi, sipas KShH vendimet e KPK mund të ishin më të unifikuara në argumentimin ligjor të këtyre shkaqeve, nisur dhe nga detyrimet që kanë subjektet për t'i vërtetuar institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër.
- Nga praktika rezulton se nuk janë trajtuar njësoj rastet kur shkak për shkarkimin e subjektit ka qënë mungesa e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të disponuara prej tyre.⁵³ Për shëmbull kur subjekti i rivlerësimit e ka patur të pamundur të disponojë dokumenta që justifikojnë veprimin financiar për shkak të marrëdhënieve jo formale me familjarët me të cilët janë realizuar këto veprime në cash, ka rezultuar se KPK ka mbajtur qëndrime të ndryshme për subjekte të ndryshme, për deklarimin e pamjaftueshëm sipas neneve 33 dhe 39 të ligjit nr.84/2016.⁵⁴ Edhe pse është vënë në dukje nga KShH evitimi i i standarteve të ndryshme për këtë tregues, KPK e ka vlerësuar fillimisht me hezitim, për ta korrigjuar më tej praktikën e vendimarrjes për këtë tregues.

⁵⁰KPA, Vendimi Nr. 09 datë 18.04.2019, faqe 24; shih para. 4, fq 17 i Vendimit 23/2019

⁵¹Kolegji i Posaçëm i Apelit, Vendimi Nr.19/2019

⁵²Ligji Nr. 9049

⁵³Shih rastet e evidentuara në tabelën 1 në aneks

⁵⁴Shih tabela 12 në aneks

- Një element tjetër i diskutueshëm është kur subjekti apo personi i lidhur me të nuk justifikojnë të ardhurat për të cilat nuk ka paguar tatim në burim,⁵⁵ si p.sh të ardhurat nga emigracioni, të cilat mund të jenë krijuar shumë vite më parë, por që nuk kanë pasur detyrimin ligjor për ruajtjen e dokumentave. Në këtë kontekst, është krijuar për subjektet e rivlerësimit një debat ligjor dhe fiskal për të ardhurat e siguruara nga puna e tyre në emigracion,⁵⁶ pasi sipas doktrinë pagimi i taksave nuk ligjëron pasurinë, ose të ardhurat, ashtu sikurse mospagimi i detyrimeve tatimore nuk e cilëson pasurinë si të jashtëligjshme.⁵⁷ Për këtë ka lindur si nevojë unifikimi i interpretimit nga ana e organeve të vetëqytetë për dispozitat që rregullojnë kategoritë e të ardhurave të ligjshme sipas Nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, si dhe kategoritë e burimit të të ardhurave të parashikuara në ligjin 8438/1998 “Mbi tatimin mbi të ardhurat”. Më konkretisht në Nenin 4 të këtij ligji, përfshihen si burime të ardhurash marrëdhëniet e punës së ushtruar brenda vendit, të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, veprimtari të tjera personale brenda vendit, si dhe të ardhura të tjera.
- KShH ka rekomanduar një qartësim në parashikimet ligjore për një përkufizim mbi konceptet “fshehje e pasurisë”⁵⁸ dhe “deklarim i pasaktë i pasurisë”.⁵⁹ Si Kushtetuta në aneksin e saj⁶⁰, ashtu dhe ligji i vetëqytetë⁶¹ nuk arrijnë të evidentojnë siç duhet elementin subjektiv, pra qëllimin për të mos deklaruar të ardhurat kur diskutohet për fshehjen e pasurisë, një element që e dallon nga deklarimi i pasaktë i pasurisë.
- Sugjerohet gjithashtu miratimi i një metodologjie për të unifikuar analizën financiare, e cila duhet shoqëruar me një tabelë përmbledhëse.⁶² Nga vendimet e KPK-së rezulton se në analizën financiare janë marrë në konsideratë shpenzimet për jetesë, kostot e udhëtimeve, shpenzimet që i kalojnë vlerën 300,000 Lekë dhe rastet kur subjekti i rivlerësimit nuk i ka pasqyruar në deklaratat vjetore.⁶³ Sipas KShH-së, në këtë analizë financiare duhet të përfshiheshin dhe deklarimi i likuiditeteve të subjektit të rivlerësimit dhe i personave të lidhur me të,⁶⁴ apo çdo deklarim për justifikimin e shumave të parave si hua të marra nga persona në marrëdhënie të posaçme.⁶⁵

⁵⁵ Shih tabelën nr.11 në aneks

⁵⁶ Shih tabela nr.10 në Aneks

⁵⁷ Komentari mbi Reformën Kushtetuese në sistemin e Drejtësisë, botuar më 2019, faqe 532

⁵⁸ Në këto raste, organet e vetëqytetë kanë vlerësuar se mosplotësimi i deklaratave përbën pasaktësi dhe për subjektet është zbatuar masa e shkarkimit sipas nenit 61 të Ligjit 84/2016.

⁵⁹ Vendimi Nr. 112 datë 04.03.2019, faqe 15

⁶⁰ Në nenin D të aneksit Kushtetues pika 5 e tij, parashikohet se “Nëse subjekti i rivlerësimit përpikët të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”. Pra në dispozitën kushtetuese, “deklarimi i pasaktë” përbën një koncept të ndryshëm ose alternativ të konceptit “fshehje pasurie”.

⁶¹ Ndërkohë, në nenin 61, pika 3 të ligjit nr.84/2016, kur flitet për masën e shkarkimit se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm, dispozita referon në nenin 33 të të njëjtë ligj, i cili në pikën 5 të tij parashikon “fshehjen e pasurisë” apo “deklarimin e rremë”, por jo “deklarimin e pasaktë”.

⁶² Shih tabelën 2 me raste që reflektojnë mungesën e analizës financiare në aneks.

⁶³ KPK, Vendimi Nr.138 datë 09.04.2019, faqe 21; Vendimi Nr.138 datë 09.04.2019

⁶⁴ KPK ka vlerësuar në vendimmarrjen e saj se ‘Subjekti i rivlerësimit, ka pasur për detyrë të deklaronte likuiditetet në çfarëdo formë, por nuk mund të deklaronte ato likuiditete që ishin në administrim të prindërve dhe të familjes së subjektit, pavarësisht nga fakti se familja mund të kishte krijuar kursime edhe për shkak të kontributit të subjektit me të ardhurat nga paga’ (konkretisht të babait të subjektit, në vlerën 1 000 000 ALL).

⁶⁵ Shih tabela 6 në aneks

- Për llogaritjen e shpenzimeve mesatare të jetesës⁶⁶ organet e vettingut kanë zbatuar indeksin mesatar në rang kombëtar dhe jo atë individual të shpenzimeve sipas INSTAT. Kjo ka sjellë si pasojë mos pasqyrimin e shpenzimeve reale dhe efektive të subjekteve, pasi përlllogaritja e këtij zëri merr për bazë shumatoren e pagave minimale me ato maksimale. Në raste të tilla, KShH ka sugjeruar bashkëpunimin me institucionet përkatëse bankare për të marrë informacion mbi gjëndjen e llogarive konform nenit 50 pika ç të ligjit Nr.84/2016.⁶⁷
- Gjithashtu nisur nga vendimet e KPA-së, KShH ka sugjeruar një interpretim më të shtjelluar dhe të standartizuar të konceptit “pasuri në përdorim” që lidhet kryesisht me pasjen e një interesi pasuror ose ekzistencën e një konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe personit që ka në pronësi pasuritë që ata kanë përdorur për periudha të ndryshme kohore.⁶⁸
- Në shumicën e rasteve, vendimarrjet e KPK-së për shkarkimin e subjekteve kanë ardhur për shkak të mosjustifikimit të pasurisë. Në lidhje me këtë, KShH ka evidentuar se ka një boshllëk ligjor se deri në ç’masë pasuria e pajustificuar e subjekteve mund ti ngarkojë ato me vlerësim negativ në kriterin e pasurisë.

b. Kontrolli i figurës

Aneksi kushtetues dhe Ligji Nr.84/2016 parashikon si organ ndihmës në procesin e vettingut DSIK për kontrollin e figurës së gjyqtarit/prokurorit nëpërmjet verifikimit të deklaratave dhe të dhënave për të identifikuar kontaktet e papërshtatshme me krimin e organizuar. Për këtë DSIK bashkëpunon me organet e vettingut për hetimin e këtyre deklaratave, pavarësisht se sipas praktikës së vettingut ky kriter nuk ka qenë prioritar në vendimarrjen e tyre. Në lidhje me këtë çështje, KShH ka konstatuar se ka boshllëk ligjor në Nenin 39 të Ligjit të vettingut nr. 84/2016, pasi nuk është i qartë dallimi mes hartimit të një raporti paraprak dhe një raporti të rishikuar të organeve ndihmëse. Sipas këtij ligji, për të verifikuar saktësinë e informacionit në raportin fillestar, grupi i punës i organeve të vettingut në bashkëpunim me DSIK-në ka një afat 60 ditor, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë. Sipas nenit 39 pika 2 të ligji, informacioni në raportet e grupeve të punës nuk mund të bëhet publik kur rrezikon sigurinë e burimit ose kur përcaktohet nga qeveria e një shteti tjetër. Prandaj, në të gjitha rastet e tjera kur raporti fillestar i DSIK nuk klasifikohet sekret shtetëror, organet e vettingut kanë detyrim ligjor ti vënë në dispozicion subjekteve, jo vetëm raportet fillestare por dhe raportet e rishikuara nga DSIK, në funksion të realizimit të barrës së provës dhe mbrojtjes efektive.⁶⁹ Gjithashtu, KShH ka vlerësuar të nevojshme kontrollimin nëse subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

c. Kriteri i vlerësimit të aftësisë profesionale

Vlerësimi i aftësive profesionale synon të identifikojë subjektet të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes

⁶⁶Vendimi Nr. 138, datë 09.04.2019

⁶⁷Shih tabela nr.8 ne aneks

⁶⁸Shih tabela nr.9 ne Aneks

⁶⁹Shih tabela nr.15 ne Aneks

edukimit në Shkollën e Magjistraturës (ShM). Për arsye të krijimit me vonesë të KLGJ-së dhe KLP-së, gjatë periudhës tranzitore organet e vetingut janë bazuar përsa i përket kontrollit të kriterit të aftësisë profesionale, në relacionet e hartuara nga organet ndihmëse në atë kohë si KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme, duke marrë për bazë dhe rezultatet e testimit pranë ShM. Përgjithësisht mund të konstatohet se KPK ka pasqyruar në mënyrë të plotë trajtimin e të gjithë indikatorëve sipas raporteve të KLGJ-së apo KLP-së,⁷⁰ por edhe pse formalisht janë ezauruar kërkesat e ligjit për verifikimin e këtij kriteri, mund të kishte një hetim më të thelluar dhe kritik bazuar në një interpretim më të plotë të ligjit, pa cënauar thelbin e tij. Zhvillim pozitiv ka shënuar Vendimi Nr.21/2019 i KPA-së, me anë të të cilit janë evidentuar disa nën indikatorë për vlerësimin profesional të subjekteve të rivlerësimit.⁷¹ Një hap tjetër që është cilësuar si pozitiv dhe inkurajohet të ruhet si standart në të ardhmen, është që në vlerësimin e aftësive profesionale në vendimet e organeve të vetingut të reflektohen gjithashtu denoncimet e ardhura nga publiku, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, përfshirë dhe ato anonime. KPK i ka konsideruar këto denoncime dhe ka mundur verifikimin e mëtejshëm të të dhënave apo indicjeve të adresuara, duke realizuar hetim të pavarur bazuar dhe në fakte të publikuara në platforma të medias investigative.

4. Vendimarrja e organeve të vetingut

KShH ka evidentuar se vendimet e KPK-së përbajnë elementët formalë të kërkuara nga neni 57 i Ligjit nr. 84/2016, ndërsa vendimet e KPA paraqesin një standart më të mirë arsyetimi. Kjo pasi sipas nenit 66, pika 2 të ligjit nr.84/2016, Kolegji i Apelit në arsyetimin e vendimit të tij duhet të orientojë Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme. Kështu vërehet një cilësi më e lartë në vendimet e kolegjit sa i takon përmbledhjes së fakteve, evidentimit në mënyrë të strukturuar për secilin kriter të shkaqeve të ankimit, evidentimit të pretendimeve të subjektit dhe Komisionerit Publik, provave të siguruara prej tyre, provave të siguruara nga hetimi administrativ kur kryhet nga KPA, analizës kushtetuese-ligjore, dhënies së vlerësimit nga vetë trupa e KPA-së për secilin shkak ankimor dhe pretendim të palëve, deri tek referimet në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pavarësisht këtyre konstatimeve, KShH e gjen me interes që në vendimet e institucioneve të rivlerësimit të prezantohen në mënyrë të përmbledhur disa prej të dhënave statistikore të vëna në dispozicion nga organet ndihmëse (DSIK, ILDKPKI, KLD dhe PP), edhe pse këto të dhëna nuk janë përfundimtare. Po ashtu, KShH ka inkurajuar publikimin në vendimet e KPK-së, të mendimit në pakicë apo paralel të gjyqtarëve, sipas nenit 55 pika 5 të ligjit nr. 84/2016,⁷² pasi janë tregues i pavarësisë së jashtme dhe të brendshme të institucioneve të vetingut, që i shërben debatit të shëndetshëm ligjor midis anëtarëve të tyre, si dhe kontribuon në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsyetimit të një vendimi.

5. Dorëheqja e subjekteve

⁷⁰Shih: Vendim i KPK-së Nr. 404, datë 23.06.2021

⁷¹ Bazuar në treguesit e përcaktuar në nenet 71, 72, 74, 75, 76 të Ligjit 96/2016

⁷²Nga monitorimi i vendimeve të arsyetuara, në faqen e KPK, rezulton se vetëm një vendim ka mendim pakice – konkretisht Vendimi 18, datë 08.05.2018.3.14.

Nisur nga dispozitat e aneksit kushtetues, pika G si dhe neni 56 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” rezulton se trajtohen kategoritë e dorëheqjeve në dy faza të ndryshme të procesit të vetingut. Kështu sipas nenit 56 të ligjit, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duke i paraqitur kërkesën me shkrim Presidentit të Republikës, e në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. Nga praktika e organeve të vetingut ka pasur vetëm 8 raste dorëheqjesh sipas kësaj dispozite në vitin 2018. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”. KPK ka marrë në konsideratë për llogaritjen e afatit 3 muaj dhe pezullimin e zbatimit të Ligjit 84/2016 nga Gjykata Kushtetuese, po ashtu ka pranuar mundësinë e dorëheqjes dhe jashtë afatit 3 muaj.⁷³ Ndërsa dorëheqjet e subjekteve sipas aneksit kushtetues i referohen rasteve kur subjektet kërkojnë dorëheqjen nga detyra gjatë procesit të vetingut. Si rregull, në këto raste procesi i rivlerësimit ndërpritet dhe përfundon pa vendim përfundimtar.⁷⁴ Si rrjedhojë, subjekti që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet për një periudhë 15-vjeçare gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm. Deri në krijimin e Këshillave, dorëheqjet janë paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm (neni 160 i këtij ligji). Ndërkohë që edhe pse nuk është një kusht ligjor dhënia e motivacionit mbi arsyet e dorëheqjes së subjekteve të vetingut, në disa raste subjektet kanë bërë të njohur arsyet e kërkesës për dorëheqje me dëshirën e tyre.⁷⁵

VI. Të drejtat e subjekteve të rivlerësimit

Në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së organeve të mëparshme të vetingut, KShH ka evidentuar disa gjetje për disa aspekte të rëndësishme që lidhen me të drejtat e subjekteve të vetingut në tërësinë e tyre, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në të drejtën për proces të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të KEDNj-së. Në këtë drejtim, janë evidentuar gjetje për: trupat gjykuese, seancat dëgjimore, publiciteti i tyre, solemniteti, e drejta për të paraqitur prova, kohëzgjatja e procesit, e drejta për tu mbrojtur dhe dëgjuar, arsyetimi i vendimeve, si dhe ekzekutimi i vendimeve pas bërjes përfundimtare.

1. Trupat gjykuese

Nga monitorimet e seancave dëgjimore pranë KPK-së gjatë vitit 2019, është konstatuar se trupat gjykues kanë respektuar etikën e sjelljes ndaj subjekteve apo avokatëve mbrojtës. Në raste të caktuara, ka pasur pretendime nga disa subjekte se trupat gjykues janë ndikuar nga paragjykime të shprehura publikisht në media. Për shëmbull ka pasur raste kur subjektet kanë kërkuar përjashtimin

⁷³Bazuar në Nenin G të Aneksit të Kushtetutës si dhe në interpretimin e bërë në vendimin nr.78, dt.12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese, për dispozitat e Ligjit 84/2016 (nenin 56 të tij)

⁷⁴Aneksi i Kushtetutës; Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve; Neni G Dorëheqja

⁷⁵ Shih tabela nr.17 ne aneks

e anëtarit të trupës gjykuese, por nuk janë informuar për përbërjen e trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën dhe ka marrë vendimin për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e anëtarit. Ka pasur dhe raste kur shqyrtimi i kërkesës për përjashtim nga një trup gjykues është bërë me pjesëmarrjen e anëtarit për të cilin kërkohej përjashtimi, në kundërshtim të hapur nenin Ç, aneksi 1, i Kushtetutës dhe nenet 4, 49, 55, 57/1, 66/2 të Ligjit Nr. 84/2016.⁷⁶

2. Seancat dëgjimore

Vëzhguesit e KShH-së kanë monitoruar mbi 100 seanca publike të zhvilluara nga KPK dhe KPA, përgjatë të cilave nuk është konstatuar tendencë për të penguar pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Në kalendarët që aksesohen në faqet zyrtare të këtyre institucioneve publikohen rregullisht të dhënat orientuese lidhur me çështjen (subjektin dhe trupën gjykuese), vendndodhjen e zhvillimit të seancave si dhe përbërja e trupit gjykues. Megjithatë në shumë raste, KPK ka pasur tendencën për të publikuar seancat dëgjimore rreth 24 orë nga zhvillimi i tyre, kryesisht gjatë muajve Qershor dhe Korrik 2019. Ndërsa KPA i ka publikuar seancat të paktën një javë përpara datës së planifikuar. Transparenca e trupave gjykuese gjatë seancës dëgjimore me subjektet e vetingut në disa raste nuk ka qenë e mjaftueshme, pasi nuk i janë krijuar mundësitë të njihen me faktet dhe rrethanat sa i takon të treja kriteret e vetingut.⁷⁷

3. Publiciteti i seancave dëgjimore

Në tërësi, KShH vlerëson si pozitiv publicitetin e seancave të KPK-së, sjelljen e stafit përgjegjës për akomodimin dhe sistemimin e publikut në sallë, veprimet përgatitore në seancën publike që paraprijnë seancën dëgjimore. Sipas gjetjeve nga monitorimet e KShH-së rezulton se proceset e zhvilluara nga KPK kanë pasur një pjesëmarrje të gjerë të medias, vëzhguesve vendas dhe ndërkombëtarë por gjithashtu edhe të publikut. Seancat dëgjimore të KPK-së kanë qenë publike dhe gazetarët kanë patur akses në seancë, janë lejuar të dërgojnë mesazhe në format teksti nga celularët e tyre gjatë zhvillimit të seancës, si dhe të bëjnë fotografi përpara zhvillimit të seancës dëgjimore. Gjithsesi për shkak të kufizimeve në hapësirën e sallave të seancës si në KPK ashtu dhe në KPA, ka pasur raste të moslejimit të vëzhguesve dhe medias për të marrë pjesë në seancat dëgjimore. Në KPA distanca e vendosur për qëndrimin e palëve, cënon konfidencialitetin dhe privatësinë e komunikimit mes subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit ligjor. Në disa raste, kjo infrastrukturë (për shkak të kapaciteteve të kufizuara) nuk i ka mundësuar çdo të interesuari ta ndjekë atë nga radhët e publikut. KPK dhe KPA kanë miratuar në kuadër të veprimtarisë së tyre, akte nënligjore të posaçme për aksesin dhe pjesëmarrjen e mediave në seancat publike⁷⁸ të cilat parashikojnë dhe masa kufizuese kur parashikohet se: *“Kryesuesi i trupës së KPK-së mund të vendosë që t’i lejohej hyrja në sallën e seancës vetëm një numri të kufizuar grupesh regjistrimi me kamera; Nuk lejohej të regjistrohen as me zë dhe as me figurë subjekti i rivlerësimit, përfaqësuesi”*

⁷⁶Raport studimor mbi mbarëvajtjen e seancave publike të procesit të vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, faqe 5.

⁷⁷Idem, faqe 9.

⁷⁸Vendimi i KPK-së nr.18, dt. 13.03.2018 “Për miratimin e dokumentit “Rregullore për mediat” dhe KPA ka miratuar rregulloren “Për marrëdhëniet me mediat”, miratuar nga mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 11/1, datë, 13.04.2018

etj. Ndërkohë, KPA vepron në bazë të rregullores “Për marrëdhëniet me mediat”, miratuar nga mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 11/1, datë, 13.04.2018, e cila në nenin 3, afirmon karakterin publik të procesit, por në pikën 9, parashikon kufizime për regjistrimin nga ana e mediave. Masat kufizuese në këtë rregullore janë të diskutueshme sa i takon respektimit lirisë së medias, transparencës dhe karakterit publik të procesit. Kufizime të tilla, të parashikuara në të dy rregulloret e përmendura nuk gjenden në ligjet që normojnë veprimtarinë e këtyre institucioneve, të cilat janë miratuar me shumicë të cilësuar dhe renditen në nivel më të lartë hierarkik krahasuar me këto akte rregullatore me karakter normativ.⁷⁹

5. E drejta për të paraqitur prova

Organet e rivlerësimit në konkluzionet dhe vendimarrjet e dhëna kanë konsoliduar dhe unifikuar praktikën e tyre në drejtim të garantimit të parimit të pavarësisë,⁸⁰ barazisë së palëve, marrjes dhe vlerësimit të provave, si dhe parimit të proporcionalitetit. Gjatë monitorimit, rezulton se KPK ju ka njohur të drejtën palëve për të paraqitur prova të reja ose prova shtesë, si dhe parashtrime e komente dhe përgjithësisht ato janë pranuar në vendimarrjen e tij. Një aspekt i sugjeruar për përmirësim nga KShH është argumentimi në vendimet e KPK-së për kohëzgjatjen e ndryshme të afatit të paraqitjes së provave. Sipas gjetjeve, koha për njohjen me dosjen e hetimit administrativ të KPK-së ka variuar nga 5-10 ditë,⁸¹ çfarë vlerësohet e pamjaftueshme për të sjellë prova të reja gjatë procesit.⁸² Sipas KShH, subjektet e rivlerësimit duhet të kenë në dispozicion të paktën 10 ditë për paraqitjen e dokumenteve shtesë apo plotësuese, në mënyrë që të garantohet standarti për një barazi të plotë të armëve dhe për një proces hetimi administrativ efektiv.⁸³

6. Kohëzgjatja e procesit

Ligji Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” nuk parashikon në mënyrë të qartë afate për procesin e vetingut në të dyja shkallët e tij, ndaj organet e vetingut janë referuar në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Nga gjetjet e KShH-së, shkaqet e shtyrjes apo tejzgjatjet e procesit kanë qënë nga më të ndryshmet, si:

- Kur hetimi zhvillohej për më shumë se një kriter,
- Kur rastet kanë qënë komplekse për shkak të kohëzgjatjes së qëndrimit në detyrë të subjekteve dhe kompleksitetit të provave,
- Kur nevojiteshin prova nga institucionet e tjera,
- Kur duheshin hetuar pasuritë për personat e lidhur me subjektin,

⁷⁹ Dispozitat e Ligji pwr Gjykatat Administrative dhe Kodit tw Procedurws Civile, tw cilat nuk bien ndesh por janw nw harmoni me dispozitat e Ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pwrbwjnw kuadrin ligjor bazw qw sanksionon procedurwn e zhvillimit tw seancave publike dhe aspekte tw tjera procedurale pwr gjatw procesit¹⁴

⁸⁰ Çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë dhe u gjetën nga GJEDNJ në përputhje me detyrimet që burojnë nga neni 6/1 i KEDNJ

⁸¹ Në seancën gjyqësore të dt. 28 Qershor 2018, rezultoi se subjektit të rivlerësimit, në fund të hetimit administrativ të kryer nga KPK, i është njohur e drejta për të pasur akses në dosjen gjyqësore për një afat prej 5 ditësh.

⁸² Shih tabela nr.23 ne Aneks

⁸³ Bazuar në nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative 'E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime

- Kur subjektet duhej të ushtronin të drejtën e tyre për tu mbrojtur në zbatim të ligjit, për rrjedhojë kërkohej shtyrje e seancave
- Kur kërkohej nga subjektet zgjatje e afateve,
- Për shkak të efekteve që solli pandemia e Covid-19.

KShH i ka rekomanduar institucioneve të vettingut që të garantojnë ushtrimin e të drejtës së subjekteve apo avokatit mbrojtës për të parashtruar pretendimet në vëmendje të parimit të ekonomikitetit të procesit gjyqësor. Po ashtu, KPA-së i është sugjeruar të arsyetojë në vendimet e saj shkaqet e tejzgjatjes së procedurave të vecanta brënda procesit, duke penguar shqyrtimin e çështjeve në tërësinë e tyre, brënda afateve të arsyeshme. Për këtë KShH ka inkurajuar institucionet për një transparencë më të lartë të procesit, por dhe menaxhimit sa më të mirë të vonesave.

7. E drejta për tu mbrojtur/degjuar

Trupat gjykuese të KPK-së dhe KPA-së, rezultojnë se i kanë njohur subjektet me të drejtat procedurale që gëzon subjekti i rivlerësimit.⁸⁴ Përgjithësisht këto institucione kanë garantuar të drejtat e subjekteve të rivlerësimit, si e drejta për tu mbrojtur personalisht ose me avokat,⁸⁵ që i mundëson subjekteve një mbrojtje efektive dhe jo thjesht formale, si p.sh. akses i plotë në materialet e dosjes hetimore të realizuar nga organet e vettingut dhe organet ndihmëse, komunikimi i rezultateve të hetimit administrativ, dhënia e një afati të arsyeshëm për të përgatitur mbrojtjen, etj. Po ashtu subjektet, pavarësisht nga mos prezenca e tyre në seancë dëgjimore, kanë mundur të ushtrojnë përmes avokatit të drejtën për të paraqitur provat dhe prapësimet, si dhe të drejtën për tu dëgjuar lidhur me kërkesat dhe pretendimet e tyre në seancë dëgjimore.⁸⁶ Ka pasur raste sporadike kur KPK nuk ka njohur subjektet me aktet provuese të hetimit dhe konkluzionet për kalimin e barrës së provës në seancë publike. Në disa raste specifike,⁸⁷ në funksion të ekonomisë gjyqësore trupat gjykuese kanë kufizuar subjektet në parashtrimet e tyre për të evituar përsëritjet dhe për tu përqëndruar vetëm tek argumentet.⁸⁸ Po ashtu, në disa raste raportet e DSIK të klasifikuara si sekret shtetëror nuk u janë vendosur në dispozicion subjekteve, me përjashtim të rasteve kur informacioni është deklasifikuar plotësisht ose pjesërisht.

9. Referimet ose kallëzimet në prokurori

Komisioni Evropian ka rekomanduar ndaj institucioneve të vettingut të referojnë rastet në prokurori kur ka tregues të veprave penale nga subjektet e rivlerësimit. Edhe pse vetingu është një proces *sui generis* me natyrë administrative, që nuk ka si qëllim primar të ndëshkojë penalisht gjyqtarët dhe prokurorët që i nënshtrohen atij, në drejtim të llogaridhënies së magjistratëve institucionet e rivlerësimit kanë detyrim të bëjnë kallëzim në prokurori, sipas nenit 281 pika 3 e Kodit të

⁸⁴ Shih tabelen 22 ne Aneks

⁸⁵ Neni 6 i KEDNJ, si dhe Neni 42 i Kushtetutës.

⁸⁶ Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, për t'i dhënë mundësinë subjektit, të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me çështjen e saj para trupit gjykues (Vendim i KPA-së Nr.14/2021 (JR), datë 15.06.2021), sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016

⁸⁷ Shih tabela nr.23 ne Aneks

⁸⁸ Shih tabela nr.23 ne Aneks

Procedurës Penale, nëse gjatë procedimit administrativ apo pas daljes me vendim për shkarkimin e subjekteve zbulojnë të dhëna, fakte apo prova që përbëjnë vepër penale që ndiqet kryesisht. Prokuroria e Posaçme, që ushtron ndjekjen penale në mënyrë të pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme për rastet e parashikuara në nenin 135, pika 2, është kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale, kundër.

- Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese
- Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë,
- Prokurorit të Përgjithshëm,
- Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,
- Anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor
- Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,
- Ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Po ashtu, Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, zbaton dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.⁸⁹Ndërsa prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, ushtrojnë ndjekje penale ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve që nuk janë subjekte të posaçme sipas nenit 75/a gërma “c” e Kodit të Procedurës Penale, si dhe vetëm për veprat penale që nuk janë në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

a. Periudha 2021-2022

Të gjitha organet shtetërore kanë detyrim të japin informacion brenda 24 orëve dhe të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit për hetimin e çështjeve penale apo për referimin e rrethanave për vepra penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.⁹⁰Në këtë drejtim, detyrimi për kallëzimin penal lind edhe për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili ka një natyrë *quasi gjyqësore*. Sipas gjetjeve të KShH-së, nga Marsi i vitit 2018 deri në Tetor të vitit 2022, rezulton se KPK ka referuar vetëm 13 raste pranë Prokurorisë së Posaçme, ndërkohë nuk ka pasur asnjë referim nga KPA. Po ashtu vihet re se organet e vetingut edhe pse kanë regjistruar një numër të lartë denoncimesh nga ana e qytetarëve, rezulton se nuk i kanë shërbyer prokurorisë për të bërë verifikime të mëtejshme. Për periudhën 2021 – 2022, KSHH ka kryer një analizë të 21 rasteve⁹¹ të ndjekjeve penale për subjektet e vetingut të kallëzuar apo proceduar penalisht, ndër të cilët 13 prokurorë,⁹² 8 gjyqtarë, prej të cilëve 6 gjyqtarë në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, 1 gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe 1 gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Nga këto subjekte, 12 prej tyre rezultojnë të dorëhequr dhe 5 të shkarkuar, ndërsa

⁸⁹Neni 9 pika 1 dhe 2, i Ligjit nr. 95/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

⁹⁰Neni 28 i Ligjit Nr.95/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

⁹¹Dokument politikash mbi “procesi i vetingut në kuadër të integritetit në BE”, 2024.

⁹²3 prokurorë të apelit, 7 prokurorë të prokurorisë të rrethit gjyqësor, 2 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, një prej të cilëve ish-prokuror i përgjithshëm dhe 1 prokuror në Prokurorinë e Krimeve të Rënda

4 në proces në proces veting-u. Veprat penale për të cilat është bërë referimi/kallëzimi në prokurori apo ka nisur procedimi penal, rezultojnë si më poshtë:

- 11 raste janë për nenin 257/a/2 të Kodit Penal (Fshehja apo deklarimi i rremë i pasurisë), në referuar/proceduar veçmas apo së bashku me vepra të tjera penale,
- 3 raste për nenin 319/ç të Kodit Penal (Korrupsioni Pasiv),
- 1 rast i është referuar nenit 248 i Kodit Penal (Shpërdorimi i detyrës),
- në rastet e tjera, referohen nenet 143 “Mashttrimet”, 143/a/6 “Fshehja e Pronës”, 180 “Fshehja e të ardhurave”, 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, 248 “Shpërdorimi i detyrës”.

Për këto 21 raste, subjektet kallëzues apo referues të çështjeve në prokurori në 4 raste janë KPK, në dy raste Sektori i Luftës ndaj Narkotikëve në Policinë e Shtetit, në 8 raste qytetarë. Sipas analizës së rasteve nga KShH-së, sjellim në vëmendje disa gjetje si më poshtë:

- Për këtë periudhë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë filluar procedimin penal ndaj subjekteve të vetting-ut në 9 raste, ndërsa SPAK ka filluar 8 procedime penale.⁹³Lidhur me këto procedime penale, 1 prej tyre është në hetim dhe 7 prej tyre janë dërguar në gjykatë, ku një pjesë e tyre kanë rezultuar me vendimarrje fajësie.
- Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm marrin vendimet e mosfillimit të procedimit penal brenda pak ditëve nga marrja e materialit kallëzues, të cilat rezultojnë të jenë të pambështetura⁹⁴
- Në rast të transferimeve të procedimeve penale për kompetencë nga SPAK tek prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, procedimet përfundojnë me vendim mosfillimi të procedimit penal dhe subjekti rezulton të mos hetohet penalisht as nga SPAK sipas nenit 319/ç të KP për “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe as nga Prokuroritë respektive sipas nenit 257/a/2 të KP për “Fshehje apo deklarim i rremë i pasurisë”. Sipas neneve 83 e 84/1 të Kodit të Procedurës Penale në raste të tilla duhet të fillojë hetimi dhe më pas të vendoset mosfillimi i procedimit penal për të evituar mospërmblidhjen e përgjegjësisë hetimore nga organi i akuzës⁹⁵.
- Praktikë e ndjekjes penale duhen harmonizuar me procedimin pasuror të subjekteve të rivlerësimit konform ligjit anti-mafia, për konfiskimin e pasurisë apo për vendosjen e masave të sekuestros preventive ndaj subjekteve që kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale,
- Për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit konform neneve 222 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale, sugjerohet të zbatohen teknikat speciale si përgjimet e telekomunikimeve dhe ato ambientale,⁹⁶përgjimi i ambienteve private (zyrat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve), sidomos për procedimet penale për veprën penale të marrjes së rryshfetit nga gjyqtarët/prokurorët.

⁹³Prej të cilave pesë për vitin 2021 dhe 3 për vitin 2022

⁹⁴Mbështetur në faktin se vendimi i KPK-së ndaj subjektit nuk është botuar ende i arsyetuar si dhe nuk është një vendim përfundimtar, pasi ai është i ankimeshëm

⁹⁵ Sipas nenit 280 të Kodit të Procedurës Penale

⁹⁶Në drejtim të provueshmërisë për ngritjen e akuzës penale nga prokuroria dhe dënimit nga gjykata të të pandehurve në 3 raste, specifikisht për nenin 319/ç të Kodit Penal (Korrupsioni pasiv)

- Për qëllimet e hetimit, prokuroritë duhet të mbështeten në të dhëna apo dokumente nga procesi i hetimit administrativ i kryer nga organet e vetting-ut, organe ndihmëse si ILDKPKI, DSIK, si dhe të dhëna nga bashkëpunimi me agjenci të specializuara ligj-zbatuese, apo të dhëna nga autoritete të drejtësisë së vendeve fqinje apo vendeve të tjera.
- Për procedimet penale për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, të reflektohen të dhëna mbi hetimin e korrupsionit monetar për pasuritë në vlerë të konsiderueshme që rezulton e fshehur/padeklaruar, si dhe të provohet si ndërlidhen këto pasuri me veprimtaritë e dyshuara, por të pa hetuara, lidhjet potenciale të të pandehurit me segmentë të krimit apo krimit të organizuar etj.
- Të ruhet praktika për caktimin e një eksperti teknik vlerësues dhe/ose ekspertë kontabël, për të verifikuar pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe burimet e krijimit të pasurive, të të pandehurit dhe personave të lidhur me ta.
- Tejkalmi i afateve të parashkrimit për hetimin që parashikohet në nenin 66 të Kodit Penal ka penguar ndjekjen penale për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal,⁹⁷ pasi data e dorëzimit të deklaratës së vetting-ut nga subjekti në janar të vitit 2017 shërben si afat i fundit për llogaritjen e afateve të parashkrimit për këtë kategori të veprës penale. Për pasojë, për subjektet që nuk janë marrë si të pandehur deri në Janar të vitit 2022 pengohet ndjekja penale nisur nga afati 5 vjet për parashkrimin e kësaj vepre.
- Ndërkohë rezultojnë tërësisht të pa hetuara për faktet e zbuluara gjatë procesit të vettingut veprat penale në fushën e korrupsionit, afati i parashkrimit për të cilat është 10 vjet, (sipas nenit 66/c me nenin 319/ç të Kodit Penal),
- Procedimi penal nga prokuroritë has në vonesa deri në 2-3 vjet, duke marrë si referencë datën nga kallëzimi apo referimi pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.⁹⁸ Ky afat nuk evidentohet i saktë në regjistrat në prokurori pasi shënimet kryhen deri edhe pas një viti nga data e kallëzimit apo referimit. Faktorë që ndikojnë në zvarritjen e hetimeve janë transferimet e çështjeve nga SPAK drejt prokurorive të juridiksionit të zakonshëm, por dhe midis këtyre të fundit duke krijuar efekt “ping-pong”.
- Në disa raste, gjyqtari i seancës paraprake tejkalon kompetencat për çmuarjen dhe vlerësimin e provave sa i takon ekzistencës ose jo të faktit penal në ngarkim të të pandehurit, si atribut që i takon vetëm vendimarrjes së gjykatës së themelit,
- Po ashtu rekomandohet që gjyqtari i seancës paraprake të vendosë kthimin e akteve pranë prokurorisë, kur vlerëson se nuk janë hetuar plotësisht fakte në kuadër të hetimeve, të lidhura me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo pastrimit të parave, në bazë të detyrimeve që burojnë nga nenet 332/ç dhe 332/dh të Kodit të Procedurës Penale.

Gjatë kësaj periudhe, rezulton se janë dhënë 4 vendime fajësie nga GjKKO e Shkallës së parë për 4 të pandehur (subjekte të procesit të vetting-ut), 2 prej të cilëve të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal që sanksionon fshehjen dhe deklarimin e rremë të pasurisë dhe 2 të pandehurit e tjerë janë dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i

⁹⁷që parashikon një dënim gjorbë ose deri në 3 vjet burg

⁹⁸Si rregull, afatet e hetimeve paraprake, sipas neneve 323 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale llogariten nga data, në të cilën, emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale.

Kodit Penal, që sanksionon korrupsionin pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të sistemit të drejtësisë.⁹⁹Në lidhje me gjykimin e këtyre rasteve janë evidentuar disa gjetje:

- Nga pikëpamja e arsytimit që ka bërë gjykata e posaçme paraqet interes dallimi i elementëve të anës objektive të “fshehjes” dhe “deklarimit të rremë” të pasurisë, për gjykimet lidhur me akuzat penale për nenin 257/a/2. Por, rezulton se gjykatat jo gjithmonë kanë qartësuar se në cilat raste ka patur fshehje, dhe kur deklarim të rremë në aspektin e konkretizimit të elementëve të anës objektive të veprës penale.
- Në arsyetimin e vendimeve të studiuara, nuk i jepet përgjigje në masën e nevojshme, të gjitha pretendimeve të ngritura nga të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre, në lidhje me llojin dhe masën e dënimit,¹⁰⁰
- Në të gjitha vendimet e fajësisë dhe të dënimit, gjykata ka dhënë edhe dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike për 5 vjet, i cili është arsyetuar në raport me cilësitë e personit që i është besuar ushtrimi i funksioneve publike dhe veprat penale për të cilat deklarohet fajtor. Pozitiv është fakti që në disa raste përmendet se synimi final i dënimit është riedukimi dhe ri-integrimi i autorit të veprës penale në shoqëri pas kryerjes së dënimit.
- Kërkohej harmonizim i standartit vlerësues të gjykatës mbi rrezikshmërinë shoqërore dhe rrethanat lehtësuese, si dhe aplikimi i alternativave të dënimit me burgim në raste të veçanta,¹⁰¹
- Argumentet e përdorura nga GJKKO e Apelit shpesh herë janë më të zgjeruara dhe paraqesin elementë dhe tipare të veçanta që individualizojnë linjën arsyetuese të saj, krahasuar me vendimet e GJKKO-së në Shkallë të Parë.
- Pozitiv për të dyja gjykatat është referimi në vendimmarrjet e tyre i standarteve të vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dhe në disa raste edhe në konventat e ratifikuara nga shteti Shqiptar në luftën kundër korrupsionit, në kuadër të aderimit pranë Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara.

b. Periudha 2022-2025

Duke pasur parasysh numrin e dorëheqjeve dhe rasteve të vendimeve për shkarkim për shkak të kriterit të pasurisë, KShH i është drejtuar me kërkesë për informacion të përditësuar Prokurorisë së Rrethit Elbasan, Prokurorisë së Rrethit Durrës, Prokurorisë së Posaçme, Prokurorisë së Rrethit Tiranë, të cilat kanë ofruar informacion me të dhëna deri në vitin 2025,¹⁰² sa i takon rasteve të referuara ose kallëzuara pranë tyre, sipas tabelës së mëposhtme:

Periudha	Prokuroria	Prokuroria	Prokuroria	Prokuroria	Total
----------	------------	------------	------------	------------	-------

⁹⁹Gjykata ka pranuar të procedojë me rregullat e gjykimin të shkurtuar, duke e arsyetuar vendimin e saj, konform neneve 332/c dhe 403/1 të Kodit të Procedurës Penale si dhe jurisprudencës (vendimit nr.4/2012 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimit unifikues nr.2/2003 të Gjykatës së Lartë, të cilat analizohen në vijimësi

¹⁰⁰Gjykatat kryesisht kanë bazuar vendimmarrjen në nenet 47, 48 dhe 49 të Kodit Penal

¹⁰¹Sikurse është ai ndaj të pandehurës E.H

¹⁰²Përgjigje Nr.98, datë 28.01.2025 e prokurorisë rrethit gjyqësor Durrës; Përgjigje nr. 317, datë 17.01.2025 e prokurorisë Elbasan; Përgjigje nr.660/1, datë 31.01.2025 e prokurorisë rrethit Tiranë dhe përgjigjes siguruar me ane te emailit nga prokuroria e Posaçme.

2022-2025	e rrethit gjyqësor Tiranë	e rrethit gjyqësor Durrës	e rrethit gjyqësor Elbasan	e Posaçme	
Kallëzime penale	12		2	24	38
Procedime Penale	16	11	2	5	34
Vepra penale sipas KP	15 - raste per VP sipas nenit 257/a i KoP 1- rast sipas nenit 186, 180, 287 i KoP	11 - raste per VP sipas nenit 257/a i KoP	2 - raste sipas nenit 257/a i KoP	4 për veprën sipas neni 257/a, 1 për veprën sipas nenet 180 dhe 257/a	33 raste sipas nenit 257/a 1 raste sipas nenit 180,186, 287 të KP
Organi që e ka referuar	1-rast PP 9 raste ILDKPI 2 raste KPK		1 rast- SPAK 1 KPK	24- KPK	27 raste KPK-71% te rasteve te kallëzuara 9 raste ILDKPI- 23% e rasteve te kallëzuara 19 raste transferimi nga SPAK - 50% të rasteve të kallëzuara 1 rast PP
Vendime mosfillimi të hetimit	10	2			12 - 31% te rasteve te kallëzuara

Transferime për kompetencë			3	19	22- 57 % e rasteve të kallëzuara
Hetime në ndjekje	13		3		16- 47% e PP
Referime për gjykim		1	1		2 - 5% te PP
Kerkesë për pushim	5				5- 14% të PP

Sipas këtyre të dhënave rezulton se për periudhën nga viti 2022 deri në vitin 2025 në të katër prokuroritë, janë regjistruar gjithsej 38 kallëzime penale dhe për 34 raste ka filluar procedimi penal. Nga 34 procedimet penale rezulton se në 97% të rasteve subjektet ndiqen penalisht për veprën penale sipas nenit 257/a të KP¹⁰³ dhe vetëm në një rast për veprën penale sipas neneve 186, 180, dhe nenit 287 të KP (shih kualifikimet përkatëse në tabelën me lart). Nga këto procedime penale rezulton se 47% e rasteve raste janë ende në hetim, ndërsa vetëm dy raste janë në proces gjykimi (njëri rast i ndjekur nga Prokuroria e Rrethit Durrës dhe një rast nga prokuroria e Rrethit Elbasan). Ndërsa figuron se për 12 raste ose 31 % e rasteve të kallëzuara është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga prokurori. Vlen të nënvizohet se vetëm një rast në Prokurorinë e Posaçme është iniciuar kryesisht, ndërsa në prokuroritë e tjera të selektuara nuk ka pasur raste të tilla. Ndërkohë nga 7 raste të referuara për gjykim rezulton se 5 raste kanë përfunduar me vendim pushimi të çështjes nga prokurori dhe dy raste janë ende në gjykim. Analiza e të dhënave për numrin e procedimeve penale të ndjekura në gjykatë prej vitit 2019-2025 kërkon të dhëna statistikore nga të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Nga të dhënat e kampionuara vetëm për prokuroritë e monitoruara nga KShH, për periudhën 2019-2025 rezulton se janë 9 raste të proceduara penalisht që janë dërguar në gjykatë, që përbëjnë 3 % të numrit total të subjekteve me vendim shkarkimi. Ndërsa, janë ndjekur penalisht 23 raste gjatë viteve 2019-2022 dhe 34 raste gjatë viteve 2022-2025, që në total përbëjnë 21% të subjekteve të shkarkuar nga procesi i vettingut. Ky fakt evidenton nevojën për të përforcuar më tej përpjekjet nga organet e prokurorisë për të ndjekur me efektivitet të plotë rastet penale të gjyqtarëve të papërgjegjshëm.

10. Rastet e adresuara nga subjektet e rivlerësimit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Në kuadër të ushtrimit të së drejtës së subjekteve për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit të Apelit në GJEDNJ sipas ligjit për vettingun dhe Kushtetutës, dhe sipas KEDNJ-së për

¹⁰³ Refuzim i deklarimit , mosdeklarimi fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë, për persona të zgjedhur ose nëpunës publikë, apo persona që kanë detyrim ligjor për deklarim

garantimin e të drejtave tëëë subjekteve tëëë rivlerëëësimi, nëpërmjet institucionit të Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit janë siguruar të dhëna si më poshtë:

Raste të komunikuar nga GJEDNJ në total	Raste të dala me vendim	Shkelje të gjetura të Konventës	Raste në monitorim në Komitetin e Ministrave	Ekzekutimi i masave individuale/	Ekzekutimi i masave të përgjithshme
18	1. Kërkesa nr.15227/19 “Xhoxhaj k. Shqipërisë“, dt 9.02.2021	Ska			Përkthyer dhe publikuar QBZ
	2. Kërkesa nr.37474/20 “Cani k. Shqipërisë“, dt 4.10.2022	Neni 6/1 e drejta për process të rregullt	“Cani k. Shqipërisë	GJEDNJ ka orientuar ankuesin të kërkojë rishikim në KPA për process të padrejtë, por k y ankues nuk ka bërë asnjë kërkesë deri tani në KPA.	Përkthyer dhe publikuar QBZ, shpërndarë institucioneve të vetingut, të drejtësisë dhe ShM
	3. Kërkesa nr.58997/18 “Nikëhasani k. Shqipërisë“, dt 22.05.2023	Ska			Përkthyer dhe publikuar QBZ
	4. Kërkesa nr.40662/19 “Sevdari k. Shqipërisë“, dt 13.12.2022	Neni 8 e drejta për respektimin e jetës private	“Sevdari k. Shqipërisë“	Rihapje e procesit nga Kolegji i apelimit dhe rikthimi në detyrë. Mbyllja e monitorimit me vendim të KM në 9 tetor	Pagesa e shpërblimit të drejtë, Përkthyer dhe publikuar QBZ, shpërndarë institucioneve të vetingut, të drejtësisë dhe

				2024.	ShM.
	5. Kërkesa nr.41047/19 “Thanza k. Shqipërisë”, dt 4.07.2023	Neni 6/1 e drejta për proces të rregullt	“Thanza k. Shqipërisë”	GJEDNJ nuk ka orientuar kerkuesin për rihapje të procesit, por ankeusi Thanza ka kërkuar rishikim në Kolegjin e Apëlimit. Aktualisht çështja është në pritje të vendimit.	Pagesa e shpërblimit të drejtë, Përkthyer dhe publikuar QBZ, shpërndarë institucioneve të vetëgjyqësorisë, të drejtësisë dhe ShM
	6. Kërkesa nr.21141/20 “Bala k. Shqipërisë”, dt 2.05.2024	Ska			Përkthyer dhe publikuar QBZ
	7. Kërkesa nr.32489/19 “Dedja k. Shqipërisë”, dt 14.11.2024	Ska			Përkthyer dhe publikuar QBZ
	8. Kërkesa nr.16701/19 “Hoxha k. Shqipërisë”, dt 14.11.2024	Ska			Përkthyer dhe publikuar QBZ

Nga tabela, rezulton se nga 18 raste të komunikuar, GJEDNJ ka dalë me vendim vetëm për 8 kërkesa. Nga këto 8 vendime, vetëm tre prej tyre janë në proces mbikqyrje standarte për ekzekutimin e tyre nga ana e Komitetit të Ministrave në Këshillin e Evropës. Në këto tre vendime, gjykata ka rekomanduar rihapje procesi vetëm në dy rastet Cani dhe Sevdari. Pavarësisht kësaj, rezulton se kanë kërkuar rihapje procesi vetëm ankuesi Sevdari dhe ankuesi Thanza (edhe pse GJEDNJ nuk kishte rekomanduar një gjë të tillë në vendimin e saj). Nga të dhënat e siguruar nga

Avokatura e Përgjithshme e Shtetit¹⁰⁴ rezulton se ankuesi Cani nuk ka bërë kërkesë për rihapje procesi pranë Kolegjit të Apelit. Po ashtu, vlen të theksohet se vendimet e GJEDNJ-së nuk vënë në asnjë rast në pikëpyetje legjitimitetin e organeve të vetingut. Shkeljet e konstatuara më konkretisht në rastin Sevdari lidhen kryesisht me cënim të të drejtave të njeriut sipas nenit 8 të KEDNJ-së, për të drejtën për jetën private, ndërsa në dy rastet e tjera Cani dhe Thanza shkeljet lidhen me nenin 6 të KEDNJ-së për procesin e rregullt ligjor. Për rastet ku GJEDNJ ka rekomanduar rihapjen e procesit shkaqet lidhen vetëm me natyrën disproporcionale të shkeljes se të drejtave të subjekteve në raport me qëllimin legjitim që duhet të ndjekë procesi i rivlerësimit.

Nisur nga të dhënat, rezulton se nga 268 rasteve të vendimeve të organeve të vetingut për shkarkimin e subjekteve, vetëm 18 subjekte kanë ushtruar me sukses të drejtën e ankimit para GJEDNJ-së, ndër të cilët vetëm tre prej tyre kanë adresuar praktika për të cilat GJEDNJ ka gjetur shkelje. Ky fakt tregon se vetëm 7% e subjekteve të shkarkuar kanë adresuar parregullsi të procesit të vetingut në GJEDNJ, ndër të cilët vetëm 1% e subjekteve kanë arritur të gjejnë përmes Gjykatës Europiane shkelje të Konventës. Këto shifra konfirmojnë ligjshmërinë e veprimtarisë së organeve të vetingut në lidhje me standartin e të drejtave për procesin e rregullt ligjor.

IV. Denoncimet e publikut

Procesi i vetingut ka pasur një vëmendje të lartë publike, për rrjedhojë ka pasur një pjesëmarrje aktive të qytetarëve për denoncimin e fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit (neni 53 i Ligjit). Në aspektin e llogaridhënies përfshirja e publikut nëpërmjet denoncimeve ndaj subjekteve të vetingut ka pasur rëndësi të veçantë në ecurinë e procesit të hetimit administrativ. Problematike ka qënë mos relatimi i plotë në seancë dëgjimore për njohjen e publikut të pranishëm, me thelbin e këtyre ankesave. Si rregull, KPK e ka njohur subjektin dhe mbrojtësin e tij me rastet e denoncuar para zhvillimit të seancës së parë dëgjimore, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën (parashtrojnë kundërgjegjësi, prova të reja, etj.). Po ashtu rezulton se as nga përmbajtja e vendimeve nuk është pasqyruar gjithmonë nëse ka pasur ankesa të qytetarëve ndaj subjekteve.¹⁰⁵ Nisur nga monitorimet e bëra gjatë vitit 2019, mund të konkludohet se denoncimet para KPK kanë qënë kryesisht për (1) shpërdorim të detyrës nga subjektet e rivlerësimit, (2) aftësitë e dobëta profesionale, (3) shkelje të rregullave procedurale të sanksionuara në Kodet Procedurale. Vlen të evidentohet se krahas denoncimeve të qytetarëve ka pasur dhe raste të denoncimit të vetë kolegëve gjyqtarë, për kontakte të subjektit me një person të përfshirë në trafik lëndësh narkotike dhe evazion fiskal. Gjithashtu, qytetarët kanë adresuar edhe shkelje të rregullave të etikës apo situata paligjshmërie jashtë marrëdhënieve të funksionit si gjyqtar. Përgjithësisht, mund të konkludohet se denoncimet janë hetuar administrativisht, i janë komunikuar subjekteve të vetingut, si dhe kanë sjellë konstatimin e shkeljeve apo shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit.¹⁰⁶

¹⁰⁴ Pergjigje nr.131/1, datë 04.02.2025.

¹⁰⁵ Shih vendimin nr. 19, dt.14.05.2018 për subjektin M. Xh

¹⁰⁶ Shih tabelen 21 ne Aneks.

VII. Gjetje dhe rekomandime mbi përmirësimin e standarteve të procesit të vettingut

Në kuadër të objektivit për funksionim sa më të mirë të institucioneve të rivlerësimit sipas parimeve të pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies, cilësisë së drejtësisë, efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit, KShH evidenton se përgjithësisht ka pasur një përmbushje të standarteve, me përjashtim të disa aspekteve që mund të gjejnë rregullim të metejshëm. Përgjithësisht, rekomandimet e KShH-së lidhur me procesin e vettingut janë konsideruar dhe mbajtur parasysh nga organet e vettingut KPK dhe KPA, pavarësisht se në fillimet e procesit ka pasur hezitim nga ana e tyre. Megjithatë, KSHH inkurajon institucionet e rivlerësimit dhe organet ndihmëse në të ardhmen, të garantojnë standartet uniforme përmes metodave të unifikuara për verifikimin e figurës, pasurisë, dhe integritetit për magjistratët. Kjo është e rëndësishme dhe përben një objektiv thelbësor për të arritur barazinë e subjekteve, por dhe evitimin e zvarritjeve të procesit për shkak të ushtrimit të së drejtës së ankimit nga ana e tyre. Në mënyrë të vecantë, rekomandohet evitimi i standarteve të ndryshme mbi mënyrën e analizës financiare sa i takon kriterit të pasurisë, por gjithashtu dhe zbatimi i metodave të përditësuara të vlerësimit të figurës apo vlerësimit profesional. Më konkretisht, nënvizohen gjetjet si më poshtë:

- Praktikë pozitive që organet e vettingut kanë krijuar në drejtim të verifikimeve të figurës, pasurisë dhe integritetit profesional të magjistratëve vlejnë të përshtaten dhe bëhen pjesë e praktikave të punës së KLGJ-së, KLP-së dhe ILDKPKI-së.
- Lidhur me zbatimin e kriterëve për vlerësimin profesional të subjekteve, KShH thekson si një standart të sukseshëm adoptimi i një metodologjie nëpërmjet Vendimit Nr.21/2019 të KPA që parashikon aplikimin e disa nën-indikatorëve shtesë. Ky vendim mund të shërbejë si bazë për miratimin e udhëzimeve nga ana e dy organeve të KLGJ-së dhe KLP-së për të pasur një vlerësim sa më shterrues dhe gjithëpërfshirës të subjekteve për këtë kriter.
- KSHH rekomandon Kolegjin e Apelit të jetë pro-aktiv në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 281 i Kodit të 66 Procedurës Penale, duke bërë kallëzim/referim të menjëhershëm në prokurori, për të gjitha ato raste kur nga rezultatet e hetimit/procedimit të vettingut zbulohen fakte që përbëjnë elemente të veprave penale.
- Një progres pozitiv vërehet sidomos sa i takon bashkëpunimit të institucioneve të vettingut si dhe ILDKPI për referimin e rasteve në prokurori, kur subjektet janë gjetur me shkelje në lidhje me kriterin e pasurisë apo bashkëpunimin e ILDKPKI-se me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, kur të dhenat mund të përbejnë shkak për fillimin e hetimit disiplinor. Ky fakt, evidentohet nga një numër i lartë i referimeve të materialeve kallëzuese nga ana e ILDKPI-së dhe procedimeve penale të regjistruara pas vitit 2022, çfarë inkurajohet të zhvillohet me tej në të ardhmen në drejtim të përmbushjes së standartit të llogaridhënies së subjekteve të vlerësimit. Në të ardhmen, rekomandohet të behen rregullimet e duhura në legjislacionin përkatës që ILDKPKI të bashkëpunojë me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë për hetimin disiplinor të subjekteve.
- Nisur nga bashkëpunimi efikas i organeve të vettingut KPK dhe KPA me vëzhguesit e ONM-së, të cilët kanë kontribuar në hetimin administrativ me informacion të dobishëm veçanërisht

për kritere si pasuria dhe figura, KSHH vlerëson se vëzhgues ndërkombëtare¹⁰⁷ mund të atashohen në vijimësi pranë institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, për të ndarë përvojat pozitive të tyre të punës dhe ofruar sugjerime/kontribute që ndihmojnë në maturimin e përvojës së këtyre institucioneve.

- Bashkëpunimi me organet ndihmëse – Pas përfundimit të procesit të vettingut, për organet e qeverisjes së drejtësisë, në ushtrim të kompetencave që ato kanë, organe ndihmëse mund të jenë ILDKPKI, Prokurori i Përgjithshëm, Këshillat e Gjykatës, Mbledhjet e Përgjithshme të Gjyqtarëve, dhe DSIK. Nisur nga gjetjet mbi bazën e dosjeve të ECC Sky, ka rezultuar se prokurorë dhe gjyqtarë kanë lehtësuar/favorizuar segmente të krimit të organizuar përmes kontakteve të papërshtatshme me krimin e organizuar. Për rrjedhojë është e nevojshme që të përforcohen më tej filtrat e kontrollit të figurës së magistratëve në mënyrë që të përmbushin mjaftueshëm rolin parandalues.
- Bashkëpunimi i qytetarëve me organet e vettingut – Që sistemi gjyqësor të mbahet llogaridhënës, i pavarur, dhe profesional, është e rëndësishme të ruhet dhe përforcohet akoma me tej praktika e denoncimit nga ana e qytetarëve ndaj subjekteve të vettingut që ndimuan procesin administrativ të verifikimit të të tre kritereve. Për këtë KSHH vlerëson se duhet të krijohen forma të aksesit të menjëhershëm për qytetarët (përdorues të gjykatave) në mënyrë që të japin një kontribut të rëndësishëm përmes denoncimeve që ndihmojnë organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë në ushtrimin e kompetencave të tyre. Për më tepër, vlerësohet se ankesat e qytetarëve mund të ndihmojnë dhe në procesin e vlerësimit etiko-profesional periodik që kryhet nga Këshillat.
- KSHH vlerëson se transparenca e procesit të vettingut duhet të kthehet në një praktikë pozitive edhe për veprimtarinë e Këshillave. Kështu, vendimet për promovimin e gjyqtarëve/prokurorëve është e rëndësishme të publikohen në faqet e Këshillave me relacione shoqëruese, që tregojnë meritën e procesit.
- Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në përputhje me fushën e tyre lëndore të kompetencës duhet të bëjnë përpjekje serioze, përfshirë dhe Prokurorinë e Posacme e cila duhet të vijojë përpjekjet për të zhvilluar hetime të plota, efikase dhe të gjithanshme, për subjektet e vettingut, për të cilët nga ky proces, rezultojnë të dhëna apo fakte për pasuri të konsiderueshme apo për lidhje të subjekteve me krimin e organizuar. Në mënyrë të veçantë, KSHH vlerëson se hetimi i tyre duhet të shtrihet për veprat penale në fushën e korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, lehtësimit të veprimtarisë apo lidhjeve dhe angazhimit në veprimtari të krimit të organizuar dhe me organizatat kriminale.
- Procedimet penale ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të larguar nga vetting të realizuar nga SPAK për hetimet dhe gjykimet penale për fshehjen dhe mosdeklarimin e pasurisë, apo deklarimin e rremë, ndaj ish gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, dhe ish Prokurorit të Përgjithshëm, të ndahen si modele pozitive me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm ku hetimet ose po zgjasin pa rezultate ose janë mbyllur. Për këtë, inkurajohen prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK për të bashkërenduar informacionin që ILDKPKI mund të japë për gjyqtarë dhe prokurorë që nuk justifikojnë pasurinë e tyre, për të

¹⁰⁷Kryesisht prokurorë e gjyqtarë me 15 vite përvojë në BE/SHBA

thelluar hetime te plota, te gjithëanshme dhe efektive në kohë. Po ashtu, rekomandohen prokuroritë t'i kushtojnë vëmendjen e duhur fakteve të bëra publike në media gjatë procesit të rivlerësimit, për të filluar hetimin kryesisht (ex officio) në të gjitha rastet kur ka indicie publike për kryerjen e një veprë penale. Ndër të tjera, inkurajohen prokuroritë të zhvillojnë dhe hetime pasurore sipas ligjit anti-mafia ndaj subjekteve të vettingut, të cilët dyshohen se kanë kryer vepra penale si rrjedhojë e shkeljeve të renda, të konstatuara gjatë procesit të vettingut.

- SPAK nxitet që në hetimin e korrupsionit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të vlerësojë dhe kërkojë autorizimin e gjykatës, për përdorimin e teknikave speciale të hetimit konform neneve 221 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale, sikurse mund të jetë edhe përgjimi i ambienteve private (zyrat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve).
- KShH i rekomandon prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK të tregojnë kujdesin e duhur në respektimin e afateve të hetimit paraprak, motivimin e vendimeve për zgjatje të afateve të hetimit dhe njoftimin në kohë të vendimeve për zgjatjen e afatit tek të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre, konform neneve 323 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, për rastet e kallëzimeve penale apo referimeve nga institucionet publike të fillojë procedimi penal dhe të shënohet në regjistër emri i personit që i atribuohet vepra penale, me qëllim që të mos ketë vonesa që dobësojnë efikasitetin e hetimeve dhe tejzgjasin afatet reale (jo formale) të hetimeve.

Aneks

1. Statistika

	Kallëzi m Penal (KP)	Procedim Penal (PP)	Vepra penale sipas Kodit Penal (KoP)	Kualifikimi i veprës	Organ i që e ka iniciu ar	Subje kti i rivler ësimit	Statusi aktual
Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë		PP Nr.6965, dt 30.09.2022	257/a i KoP	Refuzim i deklarimit , mosdeklarimi fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë, për persona të zgjedhur ose nëpunjs publikë, apo persona që			Kërkesë për pushimin e çështjes

				kanë detyrim ligjor për deklarim			
		PP Nr.8035, 30.11.2022	257/a, 186,180,28 7 i KoP	186- falsifikim i dokumentave 180- fshehja e të ardhurave 287- pastrim i produkteve të veprës penale apo veprimt. kriminale	PRrGj Durrës		Kërkesë për pushimi n e çështjes
		PP Nr.439, 17.01.2023	257/a i KoP			F.H	Në hetim
		PP Nr.1804, 16.04.2023	257/a i KoP				Në hetim
		PP Nr.8236, 6.12.2024	257/a i KoP		PRrGj Fier		Në hetim
		PP Nr.1355, 5.12.2024	257/a i KoP			E.K	Në hetim
		PP Nr.8810, 31.12.2024	257/a i KoP			S.M	Kërkesë për pushimi n e çështjes
		PP Nr.1950, 18.03.2024	257/a i KoP		ILDK PI	H.S	Në hetim
		PP Nr.2983, 2.05.2024	257/a i KoP			P.C	Kërkesë për pushimi n e çështjes
		PP Nr.12295, 23.09.2024	257/a i KoP		ILDK PI	K.H	Vendim për pushimi n e çështjes
		PP Nr.8238, 6.12.2024	257/a i KoP		ILDK PI	O.XH	Në hetim
		PP Nr.8237, 6.12.2024	257/a i KoP		ILDK PI	A.M	Në hetim

		PP Nr.8234, 6.12.2024	257/a i KoP		KPK	Nj.S	Në hetim
		PP Nr.8340, 12.10.2024	257/a i KoP		KPK	B.M	Në hetim
		PP Nr.8235, 6.12.2024	257/a i KoP		KPK	S.K	Në hetim
Total 16 PP		PP Nr.8339, 12.12.2024	257/a i KoP		KPK	O.V	Në hetim
	KP Nr.131 40, 7.10.20 24		257/a i KoP		KPK	P.F	Në hetim
	KP Nr.131 43/202 4		257/a i KoP		KPK	E.T	Vendim për mosfilli m
	KP Nr.132 54/12.1 0.2023		257/a i KoP		Prok Përgjit hshme	F.D + E.B, Dërgi m komp etence P.Rr. Gj Durrë s	Në hetim
	KP Nr.166 66, dt 26.12.2 023		257/a i KoP		ILDK PI	A.D	Vendim mosfilli mi PP
	KP Nr.166 68, dt 26.12.2 023		257/a i KoP		ILDK PI	T.K	Vendim mosfilli mi PP
	KP Nr.166 70, dt 26.12.2		257/a i KoP		ILDK PI	A.K	Vendim mosfilli mi PP

	023						
	KP Nr.166 71, dt 26.12.2 023		257/a i KoP		ILDK PI	F.P	Vendim mosfilli mi PP
	KP Nr.166 73, dt 26.12.2 023		257/a i KoP		ILDK PI	E.H	Vendim mosfilli mi PP
	KP Nr.166 73, dt 26.12.2 023		257/a i KoP		ILDK PI	A.C	Vendim mosfilli mi PP
	KP Nr.166 74, dt 26.12.2 023		257/a i KoP		ILDK PI	B.Ll	Vendim mosfilli mi PP
	KP Nr.166 75, dt 26.12.2 023		257/a i KoP		ILDK PI	A.Q	Vendim mosfilli mi PP
Total 12 KP	KP Nr.171 8, dt 26.12.2 023		257/a i KoP		ILDK PI	R.T	Vendim mosfilli mi PP
	Kallëzi m penal	Regjistrim PP	Raste me iniciativë	Vepra penale sipas KP	Inicieu ar	Subje kti	Kërkes ë për gjykim
Prok urori a e rrethi t gjyqë	0	11 2 mosfillim PP		257/a i KoP			1

sor Durrës							
Prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan		PP nr. 606, 29.05.2023 Shpallje moskompetence , dërgim Prokurorisë Tiranë	0	257/a i KoP	Kallëzim nga PrrGj Korçë	Ish gjyqtar	Në gjykim
Total 2 PP		PP 1335/2024		257/a i KoP	Kallëzim nga SPAK dhe KPK	I.A, ish prokuror	Në hetim
	KP nr.1735 , 8.10.2024	Shpallje moskompetence, dërgim Prokurorisë Tiranë		257/a i KoP	Kallëzim nga SPAK	Ish gjyqtar	Në hetim
Total 2 KP	KPnr.1737, dt 8.10.2024	Shpallje moskompetence , dërgim Prokurorisë Tiranë		257/a i KoP	Kallëzim nga SPAK dhe KPK	Ish prokuror PRhGj Korçë	Në hetim
Prokuroria e Posaçme	KP	PP	Raste me iniciativë	Vepra penale sipas KP	Iniciuar	Subjekt	Në fazën e hetimeve paraprake
Për periudhën 01.01.2022 -	24 materialet kallëzuese	5 procedime penale, ku 4 janë shpallur vendime për moskompetence dhe 1	1	4 PP për veprën sipas neni 257/a, dhe 1 PP për veprën sipas nenet 180 dhe 257/a	KPK	Pa asnjë emërtë regjistruar	19 raste mosshpallje kompetence 19 dërgime

31.12.2024		eshte bashkuar me nje PP tjetër				nën hetim	për kompetence ne PRRGj
------------	--	---------------------------------	--	--	--	-----------	-------------------------

Më poshtë tabela pasqyron të dhëna mbi veprimtarinë e SPAK për hetimin e subjekteve të vlerësimit, gjatë viteve 2019-2022.¹⁰⁸

Raportime nga SPAK	Kallëzime	Procedime penale	Referuar Gjykatës së Posaçme
2019	6	Mosfillim	
2020	39	10 raste filluar procedim penal	<u>1 procedim penal me 1 gjyqtar me kërkesë për pushim, për VP sipas nenit 319/ç të Kodit Penal;</u> <u>2 procedime penale me 1 prokuror dhe 1 gjyqtar, me kërkesë për gjykim, për VP sipas neneve 186/1, 319/ç, 179/a, 257/a dhe 287 të Kodit Penal</u>
2021	63	47 mosfillim procedim penal	1 procedim penal me 1 gjyqtar me kërkesë për pushim, për VP sipas neneve 246 dhe 248 të Kodit Penal 2 procedime penale me 2 gjyqtarë me cilësinë e të pandehurit, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal
2022	26		dosja penale datë 31.07.2021 me të pandehur ish gjyqtarin F.L për VP sipas neni 257/a të Kodit Penal për “Refuzimin për deklaram, mosdeklarimit apo fshehjes ose deklaramit të rreme”

2. Kuadri Ligjor në fushën e sistemit të Drejtësisë

¹⁰⁸Analiza “Vlerësimi i vendimeve të institucioneve të vettingut për gjyqtarët dhe prokurorët në këndvështrimin e ndjekjes penale”, 2022 u përgatit nga ekspertët e Qendrës ALTRI.

- ▶ **Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar, përcakton rregulla të përgjithshme lidhur me rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit duke përcaktuar parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, të metodologjisë, procedurave dhe standardeve të rivlerësimit. Ky ligj përcakton rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit si dhe rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të organeve të tjera shtetërore dhe të publikut në kuadër të procesit të rivlerësimit.
- ▶ **Ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”** i ndryshuar përcakton rregulla lidhur me statusin e magistratëve, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre, pranimin dhe emërimin e tyre, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre, vlerësimin etik dhe profesional të tyre, përgjegjësisë disiplinore, penale dhe civile të tyre. Gjithashtu, në ligj, përcaktohen rregulla lidhur me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, pagës dhe përfitimeve të tjera financiare dhe shoqërore, transferimit, ngritjes në detyrë apo komandimit të magistratit.
- ▶ **Ligji nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar përcakton rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e sistemit të gjykatave në Republikën e Shqipërisë, kompetencat dhe madhësitë e gjykatave, organizimin e brendshëm të gjykatave, funksionimin e administratës së gjykatës, statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë.
- ▶ **Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”** i ndryshuar përcakton parime dhe rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të Shkollës së Magjistraturës.
- ▶ **Ligji nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”** i ndryshuar përcakton rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, kushtet, kriteret dhe procedurat për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm, marrëdhëniet e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm me institucionet e tjera shtetërore, me subjekte të tjera publike ose private dhe me publikun, funksionimin e administratës së prokurorisë, statusin e nëpunësve civilë të prokurorisë.
- ▶ **Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”** i ndryshuar përcakton rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njesisë së Pavarur Hetimore, si organe kushtetuese, sipas pikës 4, të nenit 148, të Kushtetutës, së ndryshuar. Ligji nr. 95/2016 përcakton kushte dhe procedura për emërimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përcakton kompetencat lëndore parësore dhe të tjera të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme, përcakton kushte dhe kriteret shtesë që duhet të përmbushin shtetasit për t’u emëruar, transferuar apo për t’u ngritur në detyrë si gjyqtarë ose punonjës pranë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorë dhe punonjës pranë Prokurorisë së Posaçme, si dhe për t’u punësuar pranë Njesisë së Pavarur Hetimore si dhe

përcakton marrëdhëniet e Prokurorisë së Posaçme me institucione të tjera shtetërore, subjekte të tjera publike apo private, si dhe me publikun. Gjithashtu me anë të këtij ligji përcaktohen rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendës drejtorit, hetuesve dhe punonjësve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre.

- **Ligji nr. 111, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”** ka si qëllim të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike; të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

3. Kuadri ligjor mbështetës:

- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;
- Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8678 datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 146/2014 datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 119 datë 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligji nr. 55/2018 datë 23.7.2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”;

- Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 221 datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;

4. Kuadri rregullator/strategjik mbështetës:

- Urdhri nr.20 i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë datë 31.01.2024 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës “Për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”;
- Urdhri i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë nr. 90 datë 1.8.2023 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”;
- Programi Qeverisë i Këshillit të Ministrave 2021-2025;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.88, datë 22.02.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 606, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar
- Dokumenti i Politikave “Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, Plan i Veprimit (PV) dhe Pasaporta e Treguesve - 2024 – 2030”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.290 datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS) i ndryshuar;

6. Tabela me vendime te organeve te vetingut

Tabela nr. 1 per vlerësimin e kriterit të pasurisë

Kështu, në rastin e subjektit G. H., Komisioni është shprehur se “subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar informacionin e kërkuar, por është në pamundësi reale për të provuar pagesën e tatimit në burim për këto të ardhura, duke qenë se nuk ka qenë detyrim i tij për ta paguar, si dhe nuk ka qenë në detyrë për t’u treguar i kujdesshëm në kontrollin dhe ruajtjen e informacionit.” Shih: Vendim i KPK-së Nr. 393, datë 03.06.2021.35

Kështu, në rastin e subjektit I. M., Kolegji ka arsyetuar se: “...deklarata noteriale e kryer gjatë rivlerësimit ka vlerë të kufizuar në provueshmërinë e vlerës reale të shpenzimeve të kryera nga e

bija, pasi rezulton si përpjekje për të justifikuar shpenzimet në funksion të barrës së provës.” Shih: Vendim i KPA-së Nr.8/2021 (JR), datë 09.08.2021³⁶

Konkretisht, në vendimin e subjektit I.P., KPK-ja ka vlerësuar se mungesa e burimeve të ligjshme në një balancë të vogël nuk konsiderohet shkak për shkarkimin. Shih: Vendim i KPK-së Nr. 404, datë 23.06.2021. 37Shih: Vendim i KPK-së Nr. 358, datë 19.03.2021.

Tabela nr.2 për analizën financiare

Për subjektin A.Gj,¹⁰⁹ KPK vlerëson se ai ka në pronësi të fshehur një apartament në qytetin e Durrësit, raste të cilat përmbajnë elementë të veprës penale në lidhje me krijimin dhe përdorimin e këtyre dokumentave, për të cilat organet e vettingut duhej të bëjnë kallëzim në prokurori. Më konkretisht, Kodi i Procedurës Penale në nenin 281/3 parashikon: “Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori”.

Në raste të këtij lloji, organet e vettingut duhej të bënin një analizë të saktë të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për justifikimin e pasurisë së këtyre subjekteve. Në një rast kur subjekti kishte përdorur një burim të ardhurave një kredi bankare të siguruar pas blerjes së apartamentit, KPK duhej të argumentonte paligjshmërinë e këtij burimi në një mënyrë që e bën pasurinë të pajustificuar ligjshmërisht.

Më konkretisht, në rastin e subjektit të rivlerësimit L.H është konkluduar se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën periodike të vitit 2006 dhe në deklaratën “Vetting”, duke deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhura të krijuara pas datës së lidhjes së kontratës së shitjes. Për këtë subjekt, mospërfshirja e kredisë bankare si burim për krijimin e pasurisë Apartament në vitin 2006 krijon situatën kur subjekti është në kushtet e mos mbulimit me të ardhura të ligjshme të pasurisë së krijuar dhe shpenzimeve të realizuara. Në kushtet kur Komisioni nuk është bindur për burimin e ligjshëm të të ardhurave me anë të kredisë, analiza mund të shtrihej dhe për vitin 2007, vit kur efektivisht është marrë si kredi, për të analizuar se pse kjo kredi e aplikuar një vit më vonë, nuk mund të kishte shërbyer për blerjen e apartamentit nisur dhe nga rregullat e institucionit banker për aprovimin dhe lëvrimin e kredisë.¹¹⁰

¹⁰⁹Gjithashtu vendimet e KPK-së për subjektin A. Ç30, dhe A.K31

¹¹⁰Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimi nr. 100, datë 14.01.2019, faqe 30. Në arsyetim, KPK vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi të fshehur apartamentin në qytetin e Durrësit. Këtë apartament subjekti i rivlerësimit e ka përdorur në periudha të caktuara të vitit. Referuar dokumentacionit hipotekor ai është i regjistruar në emër të kushëririt të tij, subjektit të lidhur H.Gj;KPK, vendimi i dt. 08.02.2019. KPK arsyeton se mbetet ende e paqartë se si shtëpia + truall e pasqyruar në AMTP me sipërfaqe 500 m², u regjistrua me vendim gjykatë me sipërfaqe 600 m², pra, 100 m² më shumë. Për pasurinë e sipërcituar, subjekti në deklaratimet e tij ka pohuar se është përfutur me AMTP, por duke qenë tokë truall ajo nuk mund të ndahej dhe në këto kushte babai i tij i është drejtuar Gjykatës për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së shtëpisë dhe truallit.; KPK, vendimi nr. 113, dt. 08.03.2019. Për këtë subjekt, KPK ka bërë verifikime lidhur me ligjshmërinë e krijimit të apartamenteve të banimit, të cilat janë përfutur me anë të kontratës së shkëmbimit midis firmës ndërtuese dhe subjektit të rivlerësimit. Në analizën e tij, KPK ka verifikuar origjinën e pronës, e cila është blerë nga subjekti i A,K nga pronari i mëparshëm F.A. Pasuria e paluajtshme tokë arë është përfutur nga shitësi F.A nëpërmjet AMTP- së njëra në vitin 1991 dhe një në vitin 1999. Komisioni ka analizuar këto akte dhe ka arritur në përfundim se AMTP të cilat kanë shërbyer si origjinë për krijimin e

Tabela 3 për rastet e mangësive ne formularët e deklarimit

Në rastin e subjektit R.P, KPK ka argumentuar se dokumenti ligjor, në të cilin bazohet hetimi dhe objekti i rivlerësimit kalimtar është pikërisht deklarata Vetting. Deklarimet e mëparshme mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.³⁵ Për mospërputhjet midis deklaratës Vetting dhe deklarimit të vitit 2003, në rastin konkret konstatohet se mungon qëllimi dhe dashja për të bërë deklarim të pasaktë, fshehje, apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë që vlera e paguar provohet me anë të dokumenteve ligjorë justifikuese.¹¹¹ Në rastin e subjektit të rivlerësimit E.T, mosdeklarimi i shitjes së mjetit në vitin 2012 në deklaratën periodike dhe Vetting, është argumentuar prej subjektit si pakujdesi njerëzore, dhe gjithashtu është evidentuar prej tij se nuk ka pasur impakt financiar për të vënë pasuri të mëtejshme nga shitja e saj. Ky deklarim i subjektit të rivlerësimit është përputhur me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga KPK, pasi të ardhurat nga shitja e këtij mjeti nuk kanë shërbyer si burim për blerjen e ndonjë pasurie.¹¹² Për subjektin A.B,¹¹³ KPK justifikon mosdeklarimin e gjendjeve Cash në deklaratat periodike për vitin 2003 dhe 2004, duke argumentuar se nuk duhet të merret në konsideratë gjatë procesit përfundimtar të vendimmarrjes. I njëjti standart nuk rezulton të jetë zbatuar për subjektet e rivlerësimit A. K¹¹⁴, për të cilin Komisioni, vlerëson se mosdeklarimi i të drejtave reale të pronësisë në deklarimin periodik për vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, për tetë pasuritë e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k, është pasaktësi me pasojë deklarim të pamjaftueshem të pasurive nga ana e subjektit, dhe duhet të merret në konsideratë, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes.³⁹
--

Tabela 4 për mangësitë në deklarimin e pasurisë

Në rastin e subjektit D.P kjo gjetje, nuk mund të konsiderohet si një fshehje sipas KPK-së pasi bëhet fjalë për një depozitë bankare të vitit 2003, e cila është tërhequr dhe deklaruar më pas dhe është e verifikueshme.¹¹⁵
--

pasurive të paluajtshme kanë korrigeime, fshirje Komisioni, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë tokë ARË me sipërfaqe 830 m2, e cila ka shërbyer si origjinë për përfitimin e tetë pasurive të paluajtshme nga shoqëria “****” sh.p.k.

¹¹¹Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 169, datë 26.06.2019

¹¹²Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 105 datë 12.02.2012 dhe Vendimin Nr. 116 datë 21.03.2019

¹¹³Shih Vendimin Nr. 135, datë 05.04.2019, faqe 14

¹¹⁴ Komisioni i Pavarur i Kaulifikimit, Vendimi Nr. 113 datë 08.03.2019

¹¹⁵Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 112, datë 04.03.2019, faqe 15

KPA ka konsideruar ‘pasaktësi’ deklarin e gabuar (të pasaktë pranë ILDKPKI), deklarim i cili është korigjuar më pas (përpara plotësimit të deklaratës vetting), për faktin se ky korigjim është kryer me iniciativën e subjektit të rivlerësimit – kështu KPA ka çmuar se ‘mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit i blerjes së automjetit në vitin 2005 është një pasaktësi e bërë në deklarin periodik të atij viti, i cili është ndrequr në vitin 2009, me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit’ (shih pikën 67 të Vendimit 20/2019 të KPA).

Gjithashtu lidhur me mënyrën e plotësimit të deklaratës vetting për burimin e krijimit të pasurisë në rastin kur në deklaratat vjetore është treguar burim i ndryshëm, Kolegji mban qëndrimin se; pretendimi i subjektit të rivlerësimit që në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë (vetting) 2017, huaja në fjalë ishte shlyer me të ardhurat familjare në vite dhe për pasojë, ishte e panevojshme të detajohej, nuk qëndron.

Kolegji arsyeton për pretendimet për standarte të dyfishta; se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimi i duhur i ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera nga Komisioni.¹¹⁶

Provueshmëria e pagesës së detyrimeve financiare të subjekteve të rivlerësimit, ose pasaktësitë në deklarin e detyrimeve ndaj të tretëve në rastin e subjektit G.O, ka sjellë interpretimin e Kolegjit si vijon: “Mungesa e dokumentacionit provues ligjor, që do të provonte në mënyrë bindëse vlerën dhe kohën e pagimit të shumës prej 47.680 eurosh përgjatë vitit 2009, do të konsiderohen me vlerë provuese në kuptim të këtij procesi, deklarin e subjektit të rivlerësimit të kryera në deklaratën periodike të vitit 2009, duke zbatuar në këtë mënyrë parashikimin e nenit

32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: Deklarin e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit. Duke vijuar këtë arsyetim, Kolegji pranon se do të konsiderojë se pagesa e vlerës prej 47.680 eurosh, e kryer në vitin 2009, është realizuar përgjatë këtij viti, deri në datën 31.12.2009, siç ka deklaruar subjekti i rivlerësimit.¹¹⁷

Tabela nr.5 në lidhje me fshehjen e pasurisë

Kështu, në vendimin e KPK nr. 14, datë 13.04.2018, për subjektin B.T, ky i trupa gjykuese vlerësoi se subjekti ka fshehur në deklaratën e pasurisë, të ardhurat neto nga paga e vajzës së tij, e punësuar në një institucion publik, në vlerën 148.226 Lekë. Në këtë vendim evidentohet se subjekti dhe personat e lidhur kanë detyrimin të deklarojnë të ardhurat neto si burime të ligjshme dhe gjendjet e llogarive bankare deri në periudhën e deklarit, pavarësisht nëse këto të ardhura janë krijuar ose jo nga burime të ligjshme. Lidhur me këtë çështje është e vështirë të arrish në një konkluzion, duke mos qenë në dijeni të hetimit administrativ. Mos deklarimi nga subjekti i kësaj shume mund të jetë edhe një pasaktësi në deklarim. Është e vështirë ta kualifikosh këtë shumë si fshehje jo vetëm për

¹¹⁶KPA, Vendimi Nr. 07/2019 Jr, datë 05.04.2019, faqe 16,17

¹¹⁷ Kolegji Posaçëm i Apelit Nr. 20/2019 (JR) datë 31.07.2019, faqe 13-14

shkak të vlerës jo të lartë, por sepse është llogari page, e për më tepër punëdhënësi i vajzës së subjektit është organ shtetëror.

Në Vendimin 17, datë 04.06.2018, konstatohet nga trupa e KPK (fq. 15 e Vendimit) se ‘sa u përket të ardhurave të përfituara nga ‘puna në të zezë’, i punësuar nuk mund të angazhohej në një marrëdhënie të paligjshme për të krijuar kursime të mëdha, pasi ato mund të mbulojnë vetëm nevojat ditore. Në këto kushte, Komisioni gjykon se të ardhurat e pretenduara nga bursa dhe puna në të zezë nuk janë burime të bindshme për justifikimin e kësaj pasurie’. Ky konstatim lidhur me ‘punën në të zezë’ dhe angazhimin në të për të fituar mjete monetare vetëm për të mbuluar nevojat ditore nuk është i qartë lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të ri-vlerësimit apo të subjekteve të lidhur me të, pasi individët mund të përfshihen në marrëdhënie të paligjshme apo ‘punë në të zezë’ edhe për sasi të mëdha mjete monetare.

Vlerësimi i pamjaftueshmërisë së deklarimit kërkon një vlerësim diskrecionar të organit të rivlerësimit,¹¹⁸ dhe kërkon si shkak ekzistencën e motivit apo përpjekjes për të fshehur pasurinë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Për subjekte të tjera në situata të ngjashme, qëndrimi i KPK-së apo i KPA-së rezulton i ndryshëm, pasi është arsyetuar se vlerësimi financiar duhet të kryhet jo vetëm nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit (vendimet për subjektet A.F¹¹⁹, D.S¹²⁰, A.K¹²¹).

Tabela 6 për detyrimin për të deklaruar likuiditetet për persona familjare

Shih pikën 24/2 të Vendimit 18/2019 të KPA ku Komisioneri Publik në ankimin e tij në KPA ka konstatuar se ‘subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/tjetër i lidhur me të ëbabai], nuk kanë deklaruar plotësisht e saktësisht likuiditetet në formën e llogarive bankare bashkëmërore në deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, deri në momentin kur subjekti i rivlerësimit, si në aspektin fizik, edhe në atë ligjor rezulton të jetë ndarë nga trangu familjar, ose i kanë deklaruar këto pasuri me mangësi të konstatuara gjatë hetimit të çështjes në KPK qoftë në deklaratat periodike vjetore apo në deklaratën vetting (po aty në vazhdim)’. KPA ka ndryshuar standardin e vendosur nga KPK (për të njëjtin subjekt) bazuar në provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe në analizën financiare të zhvilluar nga Njësia e tij, duke vlerësuar se ‘subjekti i rivlerësimit, ka pasur pasaktësi në deklaratimet e tij, por këto pasaktësi u shpjeguan në kuadër të marrëdhënies së posaçme familjare dhe konfirmimit nga analiza financiare se familja e subjektit, nëpërmjet babait, i cili konsiderohet në këtë rast nga trupi gjykues si person tjetër i lidhur, i ka ‘dhuruar’ shumën prej 1.000.000 lekësh, të përdorura nga subjekti për blerjen e apartamentit; KPA vendosi ta vlerësojë këtë situatë faktike si të mjaftueshme për vlerësimin e kriterit të pasurisë, duke e konsideruar

¹¹⁸ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 40 datë 17.07.2018

¹¹⁹ Kolegji i Posaçëm i Apelit, Vendimi Nr.09 datë 18.04.2019

¹²⁰ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.114 datë 11.03.2019

¹²¹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.113 datë 08.03.2019

*pasurinë në formën e likuiditeteve, të ardhura të përbashkëta të familjes të subjektit, të krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme’.*¹²²

Shih pikën 24 të Vendimit 20/2019 ku KPA ka arsyetuar se ‘ndihma financiare (prej 20 000 Euro për blerjen e shtëpisë) ka konsistuar në një hua dhe jo dhurim, pra personi tjetër i lidhur nuk ka hequr dorë nga pronësia mbi paratë e dhëna subjektit, por vetëm i ka huazuar ato në formën e një ndihme, duke i rimarrë përsëri në përmbushje të afateve të parashikuara në kontratë; personi tjetër i lidhur rezulton të ketë të ardhura që vijnë nga punësimi dhe që sigurojnë një jetesë modeste, rrethana të cilat mund të kishin një trajtim të ndryshëm në rast se do të kishim të bënim me dhurim të pasurisë. Gjithashtu fakti që personi tjetër i lidhur është treguar aktiv gjatë procesit, duke vënë në dispozicion dokumentacionin që provon të ardhurat e tij, i cili konsiderohet si dokumentacion/akte që përmban të dhëna personale, çmohet se përmbush, krahas kontratës shkresore, kriterin e konfirmimit të kësaj marrëdhënieje sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e Ligjit 84/2016’.

Tabela nr.7 per analizen financiare

Konkretisht, për subjektin H.D dhe P.Gj në analizën financiare të pasqyruar në vendimin e KPK-së⁴⁷¹²³ mungon llogaritja e të ardhurave përpara fillimit të detyrës. Gjithashtu, nuk rezulton e qartë mënyra e përlllogaritjes së kursimeve në vite. KPK ka analizuar vetëm mundësinë reale të subjektit për të krijuar pasurinë për periudhën kohore kur është krijuar, pa marrë në konsideratë kursimet e mbledhura ndër vite. Kjo praktikë është ndjekur dhe në rastin e vendimmarrjes për subjektet e rivlerësimit Xh. Z¹²⁴, B.T¹²⁵.

Në vendimin nr. 224 datë 20.12.2019, ekspertët e KShH-së evidentojnë paqartësi në drejtim të metodologjisë që është ndjekur për vlerësimin e kriterit të pasurisë ndaj subjektit. Në vendim thuhet se “Në mënyrë të detajuar sipas viteve janë konsideruar dhe përlllogaritur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet në bazë të tyre është vlerësuar mjaftueshmëria e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara nga komisioni, me të ardhura nga burime të ligjshme, sipas nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës.” Por, në përmbajtje të vendimit nuk është pasqyruar ndonjë pasqyrë përmbledhëse e analizës, nuk është evidentuar mënyra e llogaritjes së shpenzimeve, kursimeve apo normave të përdorura për llogarijen e tyre.

Tabela nr.8 per te dhenat e perdorura nga INSTAT

¹²²KPA u vu në lëvizje nga Komisioneri Publik, i cili ushtroi ankim ndaj vendimit të KPK, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe kërkoi kryerjen e një hetimi dhe vlerësimi mbi burimin e ligjshëm, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimit të pasurisë/likuiditetet, pasi sipas ankimit, hetimi i Komisionit nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së saj, në kuptim të nenit 59, pika 1 e Ligjit nr. 84/2016 (shih pika 7 e Vendimit 18/2019 të KPA)

¹²³ Shih vendimin për subjektin H.D, Nr. 108, datë 15.02.2019

¹²⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.46 datë 24.07.2018

¹²⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.14 datë 13.04.2018

Në vendimin nr. 224 datë 20.12.2019 thuhet se “shpenzimet jetike nga data 1.1.2010 deri më 31.3.2010, të përlogaritura në mënyrë proporcionale, sipas metodologjisë standard, kanë rezultuar në vlerën 153.697 lekë (referuar vendimit nr. 2224)” por nuk jepen shpjegime të mëtëjshmë çfarë nënkupton metodologjia standard apo te jepet ndonjë indeks i përdorur në llogaritje. Në këto kushte vlerësojmë së vendimi i publikuar nga KPK duhet të ishte më i plotë, më i qartë, i mirëorganizuar dhe i kuptueshëm, duke siguruar në këtë mënyrë, një nivel më të lartë transparencë për publikun.

Megjithatë për subjektin P.Gj mungon një analizë e mirëfilltë e shpenzimeve të deklaruar ndër vite dhe mundësisë për të pasur të ardhura të justifikuara me burime të ligjshme. Për vlerën, shpenzime që kalojnë shumën 300,000 Lekë dhe mënyrën e deklarimit të tyre, KPK ka konstatuar se, arritja ose jo e pragut që pasjell detyrimin ligjor për deklarimin e tyre, duhet të përlogaritet në totalin e shpenzimit përkatës, të kryer në harkun kohor të vitit për të cilin referon deklarata e paraqitur nga subjekti, dhe nuk rezulton korrekte mënyra e analizimit veçmas dhe në vetvete për çdo shpenzim apo blerje të kryer brenda vitit deklarues, edhe kur ato i përkasin të njëjtës kategori shpenzimi.¹²⁶

KPA, në rastin e subjektit të rivlerësimit A.F ka realizuar një analizë financiare lidhur me mundësinë që ky subjekt kishte për të krijuar kursime, pasi në deklaratat e pasurisë të viteve 2004 dhe 2005 ka pasur pasaktësi. Kolegji të njëjtin linjë ka ruajtur dhe për subjektin e rivlerësimit A.C dhe ka kërkuar rillogaritjen e të ardhurave për periudhën 15.10.1992-14.07.1994 dhe 10.09.1995-31.08.1997. Qëndrimi i Kolegjit se relacioni financiar i përgatitur nga këshilltari ekonomik është një akt këshillimor i trupës, nuk pajtohet plotësisht me qëndrime në vendimmarrje të tjera, ku janë vlerësuar raportet private të përgatitura nga ekspertë mbi vlerësimin e gjëndjes pasurore, por i është dhënë përparësi raportit të hartuar nga vetë këshilltarët e Kolegjit.¹²⁷

Kështu KPK në Vendimin 22/2018 (fq. 8) parashtroi se “shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit për periudhën 1992-2000 janë llogaritur përafërsisht, duke marrë në konsideratë nivelin e pagave gjatë kësaj periudhe, përbërjen familjare të subjektit, dhe si shpenzim mujor një vlerë e përafërt që zë rreth 26% të totalit të të ardhurave”.

Në një rast tjetër, në Vendimin 62/2018 të KPK-së, lidhur me analizat financiare të depozitimeve dhe pakësimeve/tërheqjeve të vlerave monetare nga bankat e kursimit i referohet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për burimin e krijimit të tyre, referuar të dhënave bankare (statement) për bankat e nivelit të dytë nga ku ata kanë kërkuar informacion, në raport me deklaratat e tyre në ILDKPKI dhe Deklaratat Vetting (shih analizën e KPK fq. 16-22), problematika e vërejtur në këtë drejtim lidhet me faktin se secila nga këto llogari analizohet e veçuar përgjatë gjithë periudhës së deklarimeve, ndërkohë që këto analiza mund të kryeheshin gjithashtu në mënyrë integrale. Kështu, për secilin subjekt rivlerësimi apo persona të lidhur me të

¹²⁶ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.116 datë 21.03.2019

¹²⁷ Shih vendimin Nr. 08, datë 16.04.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Vendimi Nr. 09 datë 18.04.2019 I Kolegjit të Posaçëm të Apelit

mund të vlerësohej burimi i krijimit të tyre, nga të gjitha bankat në mënyrë të agreguar për të gjitha vitet e deklarimit, me qëllim që të analizohej më qartë nëse subjektet kanë pasur burime të ligjshme për krijimin e të ardhurave, si kanë ecur shpenzimet brenda po atj viti, pra sa janë kredituar ose debituar llogaritë në total dhe a ka pasur mundësi subjekti të kryejë pagesa në vlera të mëdha.

Tabela nr.9 për vlerësimin e konceptit “pasuri në përdorim” të subjekteve të rivlerësimit

Në vendimmarrjen e KPK-së për subjektin e rivlerësimit L.H, konkludohet se nuk u provua me dokumentacion ligjor, burimi i ligjshëm i të ardhurave të personit tjetër të lidhur shtetasit B. H., për blerjen e këtij automjeti nga personi tjetër i lidhur, A. H.⁵⁷ Hetim i burimit të ligjshëm të pasurisë së personit të lidhur, mbart diskutimin nëse i tejkalon ose kufijtë e parashikuar nga kompetencat që ligji i ngarkon institucioneve të vettingut, në kryerjen e hetimit administrativ.

KPA ka vlerësuar se ‘*duke qenë se në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë (vetting) nuk provohet nga aktet e fashikullit gjyqësor se subjekti ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, sikundër dhe nuk rezulton që të ketë pasur një policë sigurimi TPL të vlefshme në këtë moment kohor, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e Ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim, dhe se çdo pasaktësi në deklarimet periodike të viteve të mëparshme, në drejtim të mosdeklarimit të interesit pasuror në formën e përdorimit të automjetit në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, për sa kohë nuk rezultoi gjatë hetimit administrativ nga Komisioni dhe atij gjyqësor në Kolegj ndonjë e dhënë në drejtim të ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi mes subjektit dhe shoqërisë në fjalë, këto pasaktësi nuk mund të vlerësohen si deklarim i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe si të tilla të mund ta bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit në këtë drejtim’ (shih pikën 24.3 të Vendimit 11/2019 të KPA).*

Tabela nr.10 mbi justifikimin e të ardhurave para fillimit të detyres

Në një prej vendimeve të KPA-së,¹²⁸ argumentohet se pasuritë e vëna nga subjekti i rivlerësimit, aq më tepër prej personave të lidhur, para periudhës së rivlerësimit, mund të plotësojnë e kënaqin nivelin diskrecionar për “justifikimin bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive” edhe për një nivel më të ulët të provave.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit D.P, KPK vlerëson se mospagimi i taksave për një pjesë të të ardhurave ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe se ato nuk mund të paguheshin nga vetë subjekti. Marrëdhënia e punësimit të subjektit sipas KPK-së është e ligjshme dhe të ardhurat e përfituara kanë qenë nga një marrëdhënie pune e ligjshme.¹²⁹

¹²⁸ Kolegji i Posaçëm i Apelit, Vendimi Nr 6, datë 28.02.2019, faqe 36

¹²⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Vendimi Nr. 103, datë 05.02.2019, faqe 9, shih gjithashtu faqen 11-12 të

Ndërkohë, për subjektin E.S, KPK ka mbajtur një qëndrim ndryshe duke konstatuar se në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar si të ardhura të bashkëshortes së tij vlerë më të lartë nga sa punëmarrësi i saj kishte deklaruar në organet përkatëse tatimore.¹³⁰ Subjekti në rastin konkret ka pretenduar të ardhurat që realisht ka marrë dhe jo të ardhurat të cilat punëdhënësi ka deklaruar në organet tatimore.¹³¹

Për të njëjtin subjekt, KPA, njësoj si KPK ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke vendosur lënien në fuqi të vendimit për shkarkimin e tij nga detyra. KPA, në një rast të ngjashëm konkludon ndryshe, duke arsyetuar se *“për të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga shërbimet e tij në Mbretërinë e Arabisë Saudite gjatë vitit 2006, nuk u arrit të provohet se janë përmbushur detyrimet tatimore përkatëse dhe për rrjedhojë, ato nuk përmbushin kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi”*.¹³² Në rastin e subjektit R.P, KPK, lidhur me të ardhurat e krijuara nga emigracioni ka argumentuar se, *“të ardhurat janë realizuar shumë kohë para miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës Kushtetuese të Reformës në Drejtësi, duke përfshirë dhe ligjin nr. 84/2016, të cilët përcaktuan rregulla specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet e rivlerësimit, për efekt të kontrollit e verifikimit të pasurive të tyre. Ky burim të ardhurash është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit që në deklarinë për herë të parë në vitin 2003. Për më tepër, këto të ardhura kanë qenë të depozituara në sistemin bankar që në vitin 1998, duke shuar çdo dyshim për abuzim nga subjekti me burimin e të ardhurave vetëm në funksion të deklarinë “Vetting”....64*¹³³ Për më tepër, arsyetimi vijon se, subjekti nuk kishte detyrim për ruajtjen e dokumentacionit, përse kohë që detyra e saj si gjyqtare ka filluar në vitin 2000 dhe duke marrë në konsideratë faktin e kalimit të një periudhe kohore kaq të gjatë; ka pranuar kërkesën për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga detyrimi për paraqitjen e dokumenteve që justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të pasurive, sipas nenit 32, pika 2, e ligjit nr. 84/2016 duke vlerësuar edhe të gjitha përpjekjet e tij për të provuar deklarinë e bëra.¹³⁴

Për justifikimin e burimit të ligjshëm të pasurisë në një praktikë tjetër Komisioni arsyeton se: *“Nga përmbajtja e këtij vërtetimi konstatohet se subjekti është në pamundësi objektive për të vërtetuar fitimin neto të biznesit të znj. A. B. S. në momentin e dhënies së huasë. ... Për rrjedhojë, nisur nga fakti se për periudhën 2003 – 2006, ky subjekt tregtar ka pasur qarkullim total për të cilin është paguar tatimi i thjeshtuar mbi fitimin si dhe nisur nga fakti që dhënia e huas është bërë vetëm për një afat njëmuor, Komisioni krijoi bindjen se znj. A. B. S., ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për dhënien e huas në datën 29.7.2006, duke e konsideruar të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit”*.¹³⁵

¹³⁰ Kolegji I Posaçëm i Apelimit, Vendimi Nr. 7 datë 05.04.2019, faqe 11

¹³¹ Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Vendimi Nr.7 datë 08.04.2019

¹³² Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Vendimi Nr 6, datë 28.02.2019, faqe 23

¹³³ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 169 datë 26.06.2019

¹³⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Vendimi Nr.169, faqe 90

¹³⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.151, faqe 10

Tabela nr.11 për deklarimet e tatimeve në burim

Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë dhe pagimin e tatimeve (detyrimeve fiskale) për krijimin e saj, KPA ka mbajtur qëndrim krejt të ndryshëm me KPK; duke arsyetuar se “jo çdo pasuri për të cilën nuk është paguar detyrimi fiskal, duhet të kualifikohet apriori e paligjshme, pasi mundet që subjekti I rivlerësimit të shpjegojë bindshëm dhe të sjellë prova që vërtetojnë të kundërtën’... dhe vazhdon .. ‘megjithëse detyrimi fiskal për një pasuri mund të mos jetë paguar, burimi i krijimit të saj mund të rrjedhë nga një punë apo veprim juridik që ligji nuk e ndalon apo e lejon në mënyrë të shprehur. Për KPK ‘mospagimi i detyrimeve fiskale mundet të konsiderohet si shkelje e etikës së magjistratit apo shkelje administrative, por nuk mund të shërbejë si shkak për dhënien e masave disiplinore në bazë të nenit D të Kushtetutës dhe dispozitave ligjore të dala në zbatim të saj’ (shih Vendimin 46/2018 të KPK, fq. 27/1). Për të njëjtin subjekt rivlerësimi KPA ka mbajtur një qëndrim të kundërt me KPK, kur ka vlerësuar se “në kontekstin e procesit të rivlerësimit, deklarimi i saktë dhe i plotë i burimit të krijimit të pasurisë dhe të ardhurave, si dhe ligjshmëria e këtij burimi është kusht thelbësor për të kaluar testin e kriterit të vlerësimit të pasurisë. Për këtë qëllim, subjektet duhet të paraqesin dokumentacion provues mbi përmbushjen e detyrimeve tatimore; në të kundërt, burimi, e ardhura dhe pasuria e krijuar do të konsiderohen të paligjshme dhe, për rrjedhojë, krijohen kushtet e pamjaftueshmërisë për kriterin e kontrollit të pasurisë’ (shih pika 22.12 dhe 22.13 e vendimit 19/2019).

Tabela 12 për rastet kur deklarimet janë te pamjaftueshme

Në vendimmarrjen e KPK-së për subjektin D.P konkludohet se; kur nga një analizë financiare që i referohet një segmenti kohor prej rreth dy dekadash, rezulton një mungesë financiare minimale, e shpërndarë ndër vite, ajo mund të tolerohet, jo vetëm për mundësinë e ndonjë pasaktësie në parametrat e përdorur përgjatë procesit të përlllogaritjeve, por edhe në funksion, pikërisht, të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, duke çmuar se nuk konstatohen elementë të majftueshëm që të çojnë në aplikimin e masës së parashikuar në pikën 1/c të nenit 58.74¹³⁶

Gjithashtu, për subjektin E.T konstatohet se megjithëse subjekti nuk ka kryer deklarimin e gjendjes cash për periudhën 2012-2016, nga ana e Komisionit ky fakt në vetvete ka qenë I pamjaftueshëm për të pasqyruar zbatimin e shkaqeve ligjore për shkarkim të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016.75 Pasaktësitë në deklarim nga subjekti nuk gjykohen se çënojnë vlerësimin e pasurisë së tij.76 Gjithashtu në vijim të justifikimit të pasaktësive në deklarim konkludohet se; mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

¹³⁶ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Vendimi Nr. 112 dt 04.03.2019, faqe 31

I njëjti argument nuk është ndjekur në vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit A. K, për të cilin trupa gjyquese e KPK-së vlerëson se mosdeklarimi i të drejtave reale të pronësisë në deklarin periodik për vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, për tetë pasuritë e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k, është pasaktësi me pasojë deklarim të pamjaftueshem të pasurive nga ana e subjektit, dhe duhet të merret në konsideratë, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes.¹³⁷ Gjithashtu për subjektin H. D79¹³⁸ trupa gjyquese e KPK-së mban qëndrimin se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, përse i takon vlerësimit të kriterit të pasurisë, duke theksuar se nuk ka pasur mundësi financiare për të shlyer këstet e kredisë në vite.⁸⁰¹³⁹ Ndërkohë, KPA, në ndryshim nga linja e mbajtur nga KPK ka vendosur standardin se ‘mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet (vetëm) për vitet 2011 dhe 2013 e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e Ligjit 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, si një kriter që justifikon zbatimin ndaj tij të masës disiplinore, shkarkim nga detyra’ (shih pikën 79 të vendimit 20/2019 të KPA).

Gjithashtu, edhe në një rast tjetër KPA arriti në konkluzionin se “për sa kohë nuk u arrit të provohet burimi i krijimit të të ardhurave të deklaruara gjatë shqyrtimit gjyqësor se kanë shërbyer si burim për krijimin e tri pasurive të paluajtshme, ... subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëjetuesja e tij) kanë kryer deklarim të paplotë të tri pasurive në deklaratën e pasurisë (vetting) dhe atë periodike vjetore të vitit 2005, sa i takon burimit të krijimit, deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë (vetting) të të ardhurave nga puna, si dhe ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar të tria këto pasuri të paluajtshme, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe Ligjit 84/2016’ (shih pikën 20.13 të vendimit 11/2019 të KPA).

Edhe në një rast tjetër, KPA ka argumentuar se ‘trupi gjyqësor arrin në konkluzionin se “subjekti i rivlerësimit ka kryer **deklarim të paplotë dhe të pasaktë** të pasurive të tij në deklaratën e pasurisë (vetting) në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, **me qëllim shmangien nga kontrolli**, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ... “.

Në rastin e subjektit R.H, të konfirmuar me shumicë votash në KPK, vendimi paraqet edhe mendimin e komisionerit kundër. Anëtarë L.H argumenton: “Nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës..... për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas meje, nuk arriti një nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë”.

Tabela 13 mbi riçeljen e hetimit

Kështu, në rastin e subjektit D.M, rezulton se në datën 22.11.2019, subjekti i është drejtuar KPK-së, me objekt riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e figurës. Me vendimin nr.3, datë 22.11.2019,

¹³⁷ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 113 datë 08.03.2019

¹³⁸ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 108, datë 15.02.2019, faqe 29

¹³⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 108 datë 15.02.2019, faqe 29

trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim tri kërkesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vendosi mospranimin e tyre.

Refuzimi i kërkesës për ricçljen e hetimit administrativ është vënë re edhe në vendimin e subjektit B.M, për të cilin, pas analizimit të tria kriterëve, komisioni vendosi shkarkimin e saj. Ndërsa në rastin A.V33, për shkak të evidentimit dhe administrimit të provave të reja nga Komisioni, pas mbylljes së hetimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë – trupi gjykues vendosi riçeljen kryesisht të hetimit administrativ, si dhe njoftoi subjektin lidhur me këtë vendim. Subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision nëpërmjet postës elektronike, kërkesë për rihapjen e hetimit dhe vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe njohjen me të gjithë dokumentacionin e grumbulluar nga Komisioni edhe për këto dy kriteret. KPK, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, vlerësoi se deri në këtë fazë të hetimit, provat e grumbulluara kanë arritur nivelin e provueshmërisë sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 52, të ligjit 84/2016 dhe vendosi: mospranimin e kërkesës, duke njoftuar subjektin e rivlerësimit për këtë vendim.

Në rastin e subjektit A.XH., KPK vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar në kriterin e pasurisë, duke e shkarkuar subjektin dhe duke bazuar ndër të tjerash vendimmarrjen, në nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 që parashikon se: “Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji”. Nga leximi literal i këtij neni vërehet se ligjvënësi ka reflektuar qasjen kumulative nëpërmjet përdorimit të lidhëzes “dhe”, si rrjedhojë subjekti duhet të realizojë deklaram të pamjaftueshëm për të dy kriteret e vlerësimit, në mënyrë që masa disiplinore e dhënë në ngarkim të tij të përligjet nga aplikimi i kësaj dispozite ligjore. Pavarësisht se Komisioni ka vendosur përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm bazuar në kriterin e pasurisë, rezulton se deklarimi i pamjaftueshëm lidhur me kriterin e figurës ka ndikuar në këtë vendimmarrje.

Kërkesa e depozituar nga subjekti M.B. për të rihapur hetimin administrativ edhe për dy kriteret e tjera, rezulton të mos jetë pranuar nga trupi gjykues i KPK-së. Në vendimmarrjen përfundimtare nuk pasqyrohet shkaku/argumentat e refuzimit, ndërkohë që provat e reja të depozituara nga ana e subjektit u administruan nga trupi gjykues. I ndryshëm rezulton standarti reflektues në vendimmarrjen e KPK-së lidhur me përcaktimin e shkakut/argumentave të refuzimit të kërkesës për riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera, parashtruar nga subjekti A.XH. Në këtë rast, KPK I ka pasqyruar ato në vendimmarrjen përfundimtare ku thuhet se “subjekti nuk paraqiti prova dhe dokumente shkresore për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë, të tilla që do të bënin të domosdoshëm riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera”.

Tabela nr.14 mbi kontrollin e figurës

Në një rast, KPK ka konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës pasi subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e

organizuar.¹⁴⁰Në disa vendime të tjera të KPK-së, organet e vettingut kanë kryer një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjekteve të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese.

Kështu për subjektin A.M, rezulton se KPK ka kërkuar nga DSIK që të përditësojë raportin fillestar, i cili përfshinte informacione të reja të marra që nuk ishin përfshirë në raportin e kontrollit të figurës. Në këtë rast, edhe pse DSIK konfirmoi vlerësimin fillestar të përshtatshmërisë për vazhdimin e ushtrimit të detyrës, KSHH-ja konstatoi se vendimi nuk përmend të dhënat apo indikacionet që e shtynë KPK-në të kërkonte përditësimin e raportit fillestar.

Në një vendim tjetër po ashtu DSIK ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Në këtë vendimarrje për subjektin D.B, mënyra se si është artikulluar argumentimi për të argumentuar se DSIK nuk ka ndryshuar konstatimin fillestar, edhe pas hetimit administrativ, përbën një mungesë të standartit të qartësisë dhe transparencës ndaj publikut. Pasi shprehja “në përfundim, DSIK-ja, pavarësisht të dhënave të siguruara nga autoritetet verifikuese, nuk ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimi për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës” krijon një hapësirë për të interpretuar se pavarësisht se autoritetet verifikuese kanë siguruar të dhëna që mund të ishin dhe kompromentuese për subjektin, DSIK nuk ka ndryshuar qëndrimin e tij. Në këtë rast, KPK duhej të kishte sqaruar më shumë për opinionin publik cilat ishin të dhënat e reja të siguruara për këtë subjekt, ose së paku të cfarë natyre ishin këto të dhëna.

Në një rast tjetër,¹⁴¹KPA ka konstatuar të meta në vendimarrjen e KPK në lidhje me mënyrën e vlerësimit të kontrollit të figurës. Në këtë vendim subjekti ka shfaqur qëndrimin se sekreti shtetëror ka çenuar të drejtën e tij për t’u njohur me aktet që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë proces. Kjo kërkesë e subjektit është rrëzuar si e pabazuar nga ana e KPA-së, duke u mbështetur në kriteret e deklasifikimit dhe përjashtimet nga ky proces të parashikuara në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.¹⁴²

Tabela nr.15 mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Konkretisht, procesi i vettingut ndaj subjektit prokuror A.M., ka filluar pas konstituimit të KLP-së (Dhjetor 2018), por ndaj këtij subjekti nuk është administruar relacion nga ana e KLP-së, por vetëm nga grupi i punës i ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme.⁴⁸ Ndërkohë në analizën e kriterit të aftësisë profesionale të subjekteve në radhët e gjyqësorit, D.B. dhe M.M., vendimarrja e KPK-së është bazuar në raportin e hartuar nga KLD dhe nga KLGJ,4950 Nga raportet e mëparshme studimore të KShH-së është vënë re, se denoncimet e qytetarëve në përgjithësi nuk kanë patur peshë të rëndësishme në vendimarrjet e organeve të vettingut.

¹⁴⁰ Subjekti P.M

¹⁴¹ Lidhur me çështjen e subjektit A.B

¹⁴² Kjo vendimarrje është bazuar edhe në standartin e vendosur me praktikën gjyqësore të Dhomës së Madhe të Gjykatës së Strasburgut (GJEDNJ), konkretisht çështja Regner kundër Çekisë, 2017 (Dhoma e Madhe)

Kështu, në rastin e subjektes A.J, ndaj së cilës ishin depozituar 10 denoncime, trupi gjykues arriti në përfundimin se ka zbatuar ligjin brenda kompetencave të saj si drejtuese dhe se mosveprimet e saj të konstatuara në dy raste, nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin profesional të saj me mangësi apo të papërshtatshëm¹⁴³. Në këtë vendimmarrje që konfirmon subjektin në detyrë, nuk rezulton të jetë marrë në konsideratë opinionin e vëzhguesit ndërkombëtarë (i cili në fakt nuk është i detyrueshëm)⁵². Pas dhënies së vendimmarrjes nga KPK, ONM rekomandoi rivlerësimin e subjektit në shkallë të dytë. Lidhur me këtë subjekt, Komisioneri Publik rezulton se ka paraqitur më pas ankim pranë KPA-së.

Për shembull, në rastin e subjektit A.K53, Komisioni ka shqyrtuar 14 denoncime të ardhura nga qytetarët pa e bërë publike përmbajtjen apo trajtimin e tyre dhe është ndalur në disa rrethana dhe dinamika ngjarjesh të publikuara nga një program televiziv investigativ. Subjektit të rivlerësimit, pasi është studiuar përmbajtja e këtij materiali të medias, i është bërë me dije, duke e ftuar, që të jepte shpjegimet e tij. Komisioni, lidhur me çështjen në fjalë dhe me faktet e përshkruara nga subjekti, ka konstatuar shkelje të së drejtës të të pandehurve megjithatë, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë dosjen përkatëse pranë KLGJ-së, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje.

Për një nga denoncimet e ardhura ndaj këtij subjekti, vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-sw ka paraqitur opinion me nr. *** prot., datë 14.11.2019, sipas të cilit përfshirja e tre prokurorëve të ndryshëm në fazat fillestare të hetimit, edhe pse bëhet fjalë për muajin gusht, nuk tregon menaxhim të duhur të burimeve të institucionit dhe të sistemit të gatishmërisë, pasi modalitete si ato, të ndodhura në çështjen e sipërpërmendur mund të çojnë, përfundimisht në dëmtim të vetë hetimit disiplinore. Pavarësisht nga shkeljet, KPK ka vlerësuar se problematikat që kanë rezultuar nuk mund të klasifikoheshin si shkelje apo mangësi të rënda profesionale.

Në rastin e subjektit A.M., denoncimi i depozituar një ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore, detyroi trupin gjykues të vendoste riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit. Megjithatë, në përfundim, trupi gjykues i KPK-së vendosi ta cilësonte trajtimin e këtij denoncimi me një peshë më të vogël, duke argumentuar se ka të bëjë me vlerësimin e cilësive drejtuese të subjektit të rivlerësimit dhe jo me aftësitë etiko profesionale të tij apo integritetin dhe figurën si prokuror.⁵⁵Ky konkluzion është i diskutueshëm në vlerësimin tonë, sa kohë KPA ka elaboruar metodologjinë dhe nënindikatorët e vlerësimit të aftësive profesionale.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit G.M. (i analizuar në vendimin e KPA-së nr. 21/2019), vlerësimit të aftësive drejtuese i është kushtuar një vëmendje e veçantë, duke u argumentuar se “vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën “shumë mirë” ka përparësi në vlerësimin si magjistrat, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar”.

Denoncimi i qytetarit, i cili ka shërbyer si një element nxitës në mënyrë që KPK të riçelte hetimin administrativ, ka qenë objekt i analizës së anëtares së trupit gjykues të këtij organi, e cila ka

¹⁴³Vendimi nr. 221 dt 10.12.2019

shprehur mendimin e saj në pakicë. Sipas këtij mendimi, evidentohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm moskryerjen e disa veprimeve procedurale, mosnjohimin e palëve në proces, mangësinë në kryerjen e hetimeve, mosnjohimin e palëve për shtyrjen e afateve, mosshortimin e një çështjeje në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, etj., elementë që krijojnë premisa për cënimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit V.M. Por, krahas këtij vendimi, vlen për tu nënvizuar si një konstatim i përgjithshëm se vendimet e KPK, diktojnë nevojën për të pasqyruar në mënyrë më të unifikuar dhe të plotë, ndjekjen dhe vënien në zbatim të metodologjisë (dhe indikatorëve të saj) për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, të elaboruar në vendimin nr.21/2019 të Kolegjit (KPA-së).

Për shembull në vendimin nr. 218 datë 10.12.2019 të KPK, vihet re se ndërsa Komisioni është ndalur gjerësisht në analizën e kontrollit të pasurisë të subjektit K.K, kriteri i vlerësimit profesional është analizuar në vija të përgjithshme.

Në raportin fillestar për subjektin N.P42., DSIK-ja konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Më pas, në vijim të kërkesës së KPK-së është përcjellë raporti i përditësuar për kontrollin e figurës, sipas të cilit, informacionet e ardhura nga autoritetet verifikuese në kohështirje gjatë periudhës së rivlerësimit kanë bërë me dije se për subjektin e rivlerësimit disponohen të dhëna në kuadrin e sinjalizimeve mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Nga ana tjetër, KShH ka evidentuar se në një rast, DSIK-ka bërë përditësim të raportit fillestar edhe vetë kryesisht, duke specifikuar se në atë fazë mungonte përgjigjja e njërit prej organeve ligjzbatuese. ku nënë rastin e subjektit E.B., Kolegji ka argumentuar se: "...mosdeklarimi nga ana e tij e refuzimit të vizës, si kërkesë e deklaratës përbën pasaktësi dhe pavërtetësi në plotësimin e formularit të deklarimit për kontrollin e figurës, veprim që sjell si pasojë dhe mosbesueshmërinë e këtij subjekti, si dhe papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës. ku subjektet janë shkarkuar në mënyrë eksplicite për shkak të papërshtatshmërisë për aftësitë profesionale, në përputhje me pikën 5 të nenit 61 të Ligjit Nr.84/2016 unifikuar në vendimin e KPA-së, ose indikatorët e vlerësimit të këtij kriteri janë të reflektuar në shumicën e vendimeve në formën e një trajtimi të përgjithshëm në raportin e organeve ndihmëse.

Tabea nr.17 ne lidhje me dorëheqjen e subjekteve

Subjektet S.K.23 dhe N.S.24, depozituan kërkesën për dorëheqje mbështetur në arsye shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur vijueshmërinë e ushtrimit të funksionit të tyre, subjekti J.Q. e mbështeti kërkesën e saj mbi motivin e angazhimit në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor,25 ndërsa subjekti O.A. ka paraqitur dorëheqjen pranë KLGJ-së për shkak të mbushjes së moshës 65 vjeç.

Pavarësisht se KLGJ nuk u shpreh në përputhje me nenin 70/3, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative, kjo nuk përbën rrethanë ndikuese mbi vendimin për pushimin e procesit të rivlerësimit, siç është arsyetuar edhe nga KPA në vendimin nr. 17/2019 (JR). sikurse është rasti i

subjektit E.K., e cila ushtronte funksionin e këshilltares ligjore pranë Gjykatës së Lartë dhe depozitoi kërkesën e saj për dorëheqje, në kohën kur ndiqte trajnimin 2 vjeçar në Shkollën e Magjistraturës. KLGJ nuk e miratoi dorëheqjen e depozituar me pretendimin se “në kushtet kur znj. E.K. ka ndërprerë marrëdhënien juridike të punësimit si ndihmëse ligjore/këshilltare ligjore (jomagjistrate) në Gjykatën e Lartë në datën 1.10.2018, pra, përpara krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (datë 12.12.2018), si dhe kur për përfundimin e kësaj marrëdhënieje është shprehur organi publik që ka vijuar të ushtrojë kompetencat e organit të emërtesës për këtë kategori të punësuarish deri në krijimin e Këshillit, ky i fundit nuk ka detyrimin dhe as mund të shprehet për këtë çështje, tashmë ligjërisht të trajtuar/mbyllur.”. Lidhur me këtë çështje, KPK argumentoi në vendimin e tij se, viti i parë i shkollimit teorik dhe praktika/stazhi në vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës janë veprimtari të kryera për shkak të statusit, ex officio si këshilltar ligjor, që subjekti i rivlerësimit gëzonte. Si rrjedhojë, trupi gjykues ka konsideruar se për sa kohë që subjekti vazhonte të gëzonte statusin e këshilltares ligjore dhe për sa kohë procesi i rivlerësimit nuk kishte përfunduar ende, është konsideruar si tërheqje nga statusi i këshilltares ligjore, tërheqje nga detyra dhe heqje dorë nga procesi i rivlerësimit.

Tabela nr.18 në lidhje me vendimmarrjen bazuar në një kriter

Në bazë të këtij parashikimi ligjor, KPK ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, dhe pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe vlerën e tyre provuese, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të bëhet edhe vetëm për kriterin e pasurisë, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kritereve të tjera’ (shih para. 21 i vendimit 23/2019 të KPA).

Kjo natyrë terminologjie rezulton të jetë përdorur dhe në vendimmarrjen për subjektin S.K. (citim). “relatori i çështjes kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm”. Në arsyetimin e kësaj vendimmarrje vërehet kontradiktoritet në analizën logjike të përdorur, pasi ndërkohë që në paragrafin 9, konstatohet se trupi gjykues ka vendosur të njoftojë subjektin se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit (duke përfshirë dhe anekset DH dhe E të Kushtetutës, të cilat i referohen kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale), në fakt subjektit i është njoftuar kalimi i barrës së provës vetëm për kriterin e pasurisë (parag.10).

Tabela nr.19 në lidhje me rolin e ONM

Kështu, në një rast të monitoruar, vëzhguesi i ONM-së, i dha subjektit disa këshilla lidhur me menaxhimin efikas të burimeve në gjykata në të ardhmen, për të shmangur vonesat në gjykim. Roli dhe detyrat që Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016 i ka kanë dhënë vëzhguesve të ONM-së janë të kufizuara vetëm me procesin e rivlerësimit dhe mbarëvajtjen e tij, por jo me aspekte të tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, siç është menaxhimi i burimeve njerëzore në të ardhmen, kompetencë e organeve të reja qeverisëse të gjyqësorit. Neni 55 pika 3 e Ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, parashikon të

drejtën e vëzhguesit ndërkombëtar për t'i drejtuar pyetje subjektit gjatë seancës dëgjimore. Në këtë mënyrë vëzhguesi ndërkombëtar ka tejkaluar kompetencat e tij.

Në një rast tjetër, mes subjektit dhe përfaqësuesit të ONM-së, pati replika në lidhje me huanë prej 5 milionë lekësh, marrë një të njohuri të familjes si edhe për ngjarjen e vitit 1997, në gjykatën e Gjyrokastërës. Vëzhguesi i ONM-së ngriti pikëpyetje mbi këtë ngjarje, duke i kujtuar se nuk është detyra e gjyqtarit të bëjë “kaubojzin”. Këto mënyra të shprehuri konsiderohen jo etike për vetë seriozitetin dhe solemnitetin që ky proces ka përcjellë tek publiku.

Kështu, për rastin e subjektit D.P, vëzhguesi i ONM-së ka paraqitur opinion dhe gjetje për një denoncim të depozituar pranë ONM-së, i cili i ka shërbyer KPK-së kur ka vendosur transferimin pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore. Një aspekt i diskutueshëm sa i takon kotnributit të deritanishëm të ONM-së në procesin e vettingut është mendimi ndryshe i vëzhguesve të ONM-së, për vendimmarrje të organeve të vettingut. Në vlerësimin e KShH-së, mendimi paralel/ndryshe i paraqitur nga vëzhguesi i ONM-së mbi vendimin e KPA-së është i diskutueshëm pasi tejkalon atributet e përcaktuara në nenin “B” të Aneksit të Kushtetutës.

Tabela nr.20 në lidhje me transparencën e seancave dëgjimore

Kështu, në seancën dëgjimore të dt.25 Qershor 2018 me subjektin V.S, ka rezultuar se relacioni i parë i ILDKPKI-së nuk përputhej me raportin e dytë të po këtij institucioni, i cili ishte kontaktuar sërish nga KPK gjatë hetimit administrativ. Ndërkohë që në relacionin e parë, ILDKPKI referonte se subjekti i vettingut nuk kishte pasur shkelje në drejtim të deklaramit të pasurisë dhe burimeve të krijimit të saj, në raportin e dytë ILDKPKI referonte se deklarimi i pasurisë nuk është bërë në përputhje me ligjin. Gjatë seancës dëgjimore nuk u shpjegua se përse KPK i kërkoi ILDKPKI-së përgatitjen e një relacioni të dytë dhe pse KPK e konsideroi raportin e dytë të ILDKPKI-së jo të bazuar në prova.

Në seancën e dt.28.06.2018, kjo është evidentuar edhe nga avokati mbrojtës i subjektit A.L, i cili ka deklaruar se vlerësimi duhet të bëhet për të tre kriteret dhe jo vetëm për atë të pasurisë. Monitorimi i Procesit të Vettingut të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në periudhën Janar 2017 – Qershor 2018.

Tabela nr.21 mbi denoncimet e publikut

Kështu, për subjektin D.S, denoncimet e publikut lidhur me aftësitë profesionale janë marrë në konsideratë nga KPK dhe në vlerësimin përfundimtar është çmuar se subjekti gëzon nivel minimal të njohurive profesionale.

Për subjektin H.D dhe A.Ç, denoncimet e paraqitura nga publiku kanë kontribuar në vendimmarrjen e KPK-së për shkarkimin e tyre, me arsyetimin ndër të tjera të cënimit të besimit të publikut.

Nga ana tjetër, ka patur edhe seanca kur relatorët e trupës janë mjaftuar vetëm me bërjen publike të numrit të denoncimeve por pa parashtruar të dhëna qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur, mbi objektin e tyre apo për arsyet e mosmarrjes së vendimit.

Vlen të theksohet rasti i subjektit R.P, që megjithëse kishte 11 denoncime nga publiku ato u vlerësuan se nuk u gjetën fakte të besueshme, të cilat mund të cenonin punën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në kuptim të pikës 4, të nenit 43, të Ligjit nr.84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Tabela nr.22 lidhur me publicitetin e seancave

Nuk lejohet të regjistrohen as me zë dhe as me 11 Subjekti I.M është shprehur se dy ditë përpara zhvillimit të seancës dëgjimore kishte depozituar prova me një material voluminoz dhe për KPK-në ka qenë i pamundur vlerësimi i tyre në më pak se 72 orë nga marrja në dorëzim. Ky pretendim u përforcua edhe nga avokatja mbrojtëse e subjektit.figurë subjekti i rivlerësimit, përfaqësuesi” etj. Masat kufizuese në këtë rregullore janë të diskutueshme sa i takon respektimit lirisë së medias, transparencës dhe karakterit publik të procesit.

Pas çeljes së seancës publike, referuar nenit 55, të Ligjit nr.84/2016, komunikohet përbërja e trupit gjykues dhe i jepet mundësia subjektit të rivlerësimit të referojë publikisht gjeneralitetet dhe funksionin përkatës për identifikim. Kryetari i trupit gjykues, konfirmon gjatë veprimeve përgatitore të drejtat procedurale të subjektit të rivlerësimit, që janë zbatuar gjatë hetimit administrativ, si: e drejta për tu njohur me rezultatet përfundimtare të hetimit administrativ dhe dokumentacionin e administruar në dosje, e drejta për të kundërshtuar gjetjet e KPK-së; për të paraqitur prova, për të paraqitur shpjegime në formë zyrtare, për të refuzuar dhënien e përgjigjes, etj. Mediat lejohen të bëjnë regjistrime (vizuale) të hyrjes në sallë të trupit gjykues dhe të çeljes së seancës nga kryesuesi i trupit gjykues. Më pas, kamerat dhe mikrofonët fiken dhe nxirren jashtë sallës ku zhvillohet seanca gjyqësore.”

Tabela nr.23 ne lidhje me procesin e rregullt

Disa subjekte kanë pretenduar se nuk kanë pasur kohë të njihen me rezultatet e hetimit.Në disa raste pyetjet nuk mund të parashtroheshin as nga trupa gjykuese dhe as nga ONM.

a) Në seancën dëgjimore të datës 21.03.2018, trupi gjykues u shpreh se nuk mund të parashtronte pyetje15 për subjektin e rivlerësimit, pavarësisht nga prezenca e avokatit të tij në këtë seancë, pasi subjekti nuk ishte personalisht i pranishëm. Në vlerësimin e vëzhguesve të KShH-së, bazuar në nenin 55, pika 3 e Ligjit 84/2016 si dhe në parimet e procesit të rregullt, trupit gjykues nuk i mohoet e drejta që të parashtrojë pyetje edhe nëse subjekti i rivlerësimit nuk është prezent fizikisht por përfaqësohet përmes avokatit. Ky i fundit rezervon gjithmonë të drejtën që të mos u përgjigjet pyetjeve.

b) Në seancën dëgjimore të datës 11.04.2018, avokatit mbrojtjes të subjektit të ri-vlerësimit ju mohua kërkesa për të thirrur një ekspert të pavarur auditimi. Në vlerësimin e vëzhguesve të KShH-së, refuzimi i kësaj kërkesë është i diskutueshëm dhe mund të cenojë parimet e procesit të rregullt ligjor¹⁶. Ligji i vettingut i jep mundësinë dhe të drejtën KPK-së të thërrasë një ekspert dhe akti i ekspertimit mund të merret në vlerën e provës (neni 49/1, gërma “b”, Neni 49/2).

Tabela nr.24 ne lidhje me te drejtën për tu dëgjuar

Pavarësisht kësaj, në seancëndëgjimore të datës 21.03.2018, trupi gjykues u shpreh se nuk mund të parashtronte pyetje (as ai e as vëzhguesit e ONM-së) për subjektin e ri-vlerësimit, pavarësisht nga prezenca e avokatit të tij në këtë seancë, pasi subjekti nuk ishte personalisht i pranishëm. Bazuar në nenin 55, pika 3 e Ligjit 84/2016 si dhe në parimet e procesit të rregullt, trupit gjykues i njihet e drejta që të parashtrtojë pyetje edhe nëse subjekti i rivlerësimit nuk është prezent fizikisht por përfaqësohet përmes avokatit, i cili rezervon gjithmonë të drejtën që të mos u përgjigjet pyetjeve.

Në një nga seancat dëgjimore, avokati mbrojtës i subjektit kërkoi paraqitjen e provave të reja me argumentin se rezultatet e KPK-së në përfundim të hetimit administrativ kishin diktuar nevojën për të paraqitur prova të reja, dhe se këto prova nuk mund të paraqiteshin gjatë afatit të lënë në dispozicion nga KPK, i cili u vlerësua si jo i arsyeshëm. Kërkesa nuk u pranua nga trupi gjykues, me arsyetimin se gjatë hetimit administrativ paraprak, subjekti i rivlerësimit ishte njohur me çdo provë që kishte rezultuar nga ky hetim.

Në një rast tjetër, u konstatua se provat e reja të paraqitura nga subjekti në seancë konfliktin me provat e paraqitura nga trupa gjyqësore e KPK-së, ndaj avokati mbrojtës kërkoi thirrjen e një eksperti të pavarur për të përcaktuar vërtetësinë e provave që konfliktin. KPK vendosi të mos pranojë këtë kërkesë, me argumentimin se KPK disponon një provë (raportin e auditimit privat si edhe analiza financiare të dhëna nga autoritetet zyrtare) ndaj akti i ekspertimit përbën një provë të panevojshme. Refuzimi i kësaj kërkesë është i diskutueshëm dhe mund të cenojë parimet e procesit të rregullt ligjor.

Në disa raste, subjektet kanë pretenduar se materialet e dosjes nuk i janë vendosur të gjitha në dispozicion, si psh analiza financiare, raportet e DSIK ose kanë kundërshtuar afatin që ju është lënë në dispozicion nga trupa gjyqësore të KPK-së për të përgatitur mbrojtjen, i cili sipas monitorimeve të realizuara nga KShH varion nga 5 deri në 15 ditë.

Në një tjetër rast, subjekti pretendoi se një pjesë e dokumenteve i janë dorëzuar, vetëm pasi ka paraqitur me shkrim pretendimet e tij. Nga subjektet janë shfaqur edhe ankesa, si psh për refuzim kërkesë për administrimin në cilësinë e provës të marrjes së një dëshmie, vetëm një ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore.

Nga monitorimet e realizuara subjektet janë shprehur lirisht për pretendimet e tyre në seancën dëgjimore dhe nuk janë refuzuar të përfitojnë nga e drejta për të mos u përgjigjur, në përputhje me pikën 3 të nenit 55 të ligjit 84/2016. Pavarësisht, se institucionet rivlerësuese kanë tagrin ligjor për të kufizuar kohën për t'u shprehur nga ana e subjektit të rivlerësimit, në përputhje me pikën 4 të nenit 55 të ligjit 84/2016, sërish në çdo seancë subjektit të rivlerësimit i është dhënë fjala për të parashtruar qëndrimin e tij.

Megjithatë, ndonëse të rralla, ka pasur raste kur subjektit i është kufizuar koha, ose i është kërkuar nga drejtuesi i seancës, të paraqesë vetëm faktet të reja dhe të anashkalojë ato që ka dorëzuar me shkrim më herët para KPK-së.

Tabela nr.25 në lidhje me arsyetimin e vendimeve

Kështu, në vendimin nr.19, dt. 14.05.2018, për subjektin M.Xh, nuk është e qartë pse KPK ka kërkuar rishikimin e aktit përfundimtar të kontrollit të deklaratës së pasurisë dhe të raportit të DSIK për subjektin. Për raportin e DSIK, mungesa e informacionit mund të lidhet me faktin se kemi të bëjmë me deklasifikim të informacionit, m.gj.th, mund të ishte bërë një analizë më e gjerë e këtij aspekti, për të pasur një përfundim të arsyetuar.

Në një vendim tjetër (nr.17, dt.04.06.2018), KPK i kërkon ILDKPKI-së opinion ligjor, por nuk sqarohet apo qartësohet në vendim se për çfarë çështjesh është kërkuar ky opinion. Në vendimin Nr. 14, datë 13.04.2018, KPK arsyeton se ‘... me vendimin nr. 4, datë 11.04.2018, trupa gjyquese refuzoi kërkesën e subjektit për caktim ekspertësh’ por nuk arsyeton në mënyrë të përmbledhur ku është bazuar kjo vendimmarrje, duke krijuar paqartësi tek lexuesi mbi bazueshmërinë e këtij vendimi. Mungesa e arsyetimit të këtij vendimi është vërejtur edhe gjatë komunikimit të tij tek subjekti, në seancën dëgjimore të vëzhguar nga monitoruesit e KShH-së.

Në një rast tjetër, Vendimi i KPK nr. 16, datë 03.05.2018 përmban terminologji të pa-përshtatshme pasi shkruhet se ‘Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit duken bindëse dhe të mjaftueshme’ (fq. 7 e Vendimit), por nuk është e qartë për lexuesin se cilat janë provat konkrete mbi të cilat është arritur ky përfundim.

Tabela nr.22 në lidhje me ndjekjen e të drejtës për informim kundrejt organeve ndihmëse të vetingut

Mosdhënia e informacionit nga organet ndihmëse, brenda afateve dhe në mënyrë të plotë çoi KShH-në ti drejtohej Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në mënyrë që të realizohej e drejta kushtetuese e informimit. Komisioneri e ka vlerësuar si të bazuar në ligj kërkesën e KShH-së për dy nga këto organe, përkatësisht për Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) duke urdhëruar këto organe të japin informacionin e kërkuar që mungonte në shkresat zyrtare drejtuar KShH-së “Kthim përgjigje”.

Komisioneri nuk e pranoi ankimin e KShH-së ndaj Prokurorisë së Përgjithshme, vendim për të cilin KShH ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë. Ndërkohë, në dt. 5 Shkurt 2018, KShH u tërhoq nga procesi i ankimi administrativ i depozituar tek Komisioneri ndaj Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje tek Komisioneri, Inspektorati na ka dërguar dy shkresa zyrtare ku vërehet se informacioni i përcjellë ka përmbushur nga pikëpamja formalo-ligjore kërkesën tonë për informacion. Edhe pas vendimmarrjes së Komisionerit, DSIK dhe ILDKPKI kanë vazhduar të mos japin informacion për disa nga pyetjet e shtruar nga KShH. KShH ka ushtruar të drejtën e padisë në gjykatën administrative ndaj këtyre dy institucioneve, pasi është cenuar e drejta për informacion nga mosveprimi i tyre në vijim të vendimit të Komisionerit. Dëshirojmë të theksojmë se, ligji për të drejtën e informimit nuk parashikon mekanizma ligjore efektiv për të detyruar organet publike që të zbatojnë vendimet e Komisionerit kur cenohet apo nuk respektohet e drejta për informacion. Argumentet e përdorura nga organet ndihmëse për mosdhënien e informacionit që ka më shumë interes për publikun, ndryshojnë nga një organ tek tjetri, duke evidentuar mungesë konsistence në drejtim të zbatimit të ligjit. Gjithashtu, këto argumenta nuk mbështeten dhe as justifikohen nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të vettingut. Kushtetuta nuk ka parashikuar specifikisht organin që do të kryejë kontrollin paraprak të deklaratës për aftësitë profesionale të dorëzuara nga gjyqtarët dhe prokurorët, ndërkohë që Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.2 (2017) ka argumentuar se sipas nenit 10/3 të ligjit organet e vlerësimit të aftësive profesionale janë Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që funksionon dhe struktura përkatëse e Prokurorisë së Përgjithshme. Nëse në rastin e DSIK-së dhe ILDKPKI-së edhe pse refuzojnë dhënia e informacionit, pranohet në mënyrë të nënkuptuar se këto institucione kishin të dhëna për konkluzionet (vlerësimet) paraprake lidhur me dy komponentët për të cilat ato ndihmojnë organet kushtetuese të vettingut, në rastin e Inspektoratit të KLD-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme referohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi se këto organe nuk disponojnë konkluzione lidhur me aftësitë profesionale përkatësisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, është e paqartë nëse në rastin e organeve ndihmëse për vlerësimin profesional, raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar⁸ që përgatisin këto organe për çdo subjekt të parashitë ose jo konkluzione ose opinione paraprake lidhur me aftësitë profesionale. Transparenca e organeve ndihmëse dhe ballafaqimi i të dhënave të tyre KShH ka reaguar publikisht për mungesën e transparencës së organeve ndihmëse ndaj organizatës tonë dhe publikut për mosvënien në dispozicion në mënyrë të plotë, të të dhënave statistikore që ju kanë rezultuar këtyre organeve në drejtim të kontrollit të figurës, pasurisë dhe aftësive profesionale të subjekteve të vettingut. Në dt. 5 Shkurt 2018, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Komisioneri) ka pranuar ankesat e KShH-së për cënimin e së drejtës së informimit dhe ka urdhëruar DSIK-në dhe ILDKPKI-në për ofrimin e informacionit të plotë statistikor në lidhje me pastërtinë e figurës si dhe ligjshmërinë e të ardhurave dhe pasurisë brenda 10-ditësh nga vendimi. Këto institucione nuk respektojnë menjëherë vendimet e Komisionerit. Në këto kushte, KShH inicioi ose u bë pjesë e proceseve gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për moszbatimin apo ankimin e vendimeve të

Komisionerit. Fillimisht DSIK¹⁴⁴ ankimoi vendimin e Komisionerit në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë, ndërkohë që për mosveprimin e ILDKPKI-së, ishte KShH që ju drejtua gjykatës administrative me kërkesë padi. Mosdhënia e informacionit nga këto organe, vlerësojmë se e cenoi përkohësisht të drejtën e informimit të publikut të garantuar në nenin 23 të Kushtetutës dhe Për Prokurorinë e Përgjithshme është ushtruar ankim ndaj Vendimit nr. 06, dt. 05.02.2018 të Komisionerit për refuzim të ankimit të KShHsë. Deri tani Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. 1966, datë 22.05.2018 ka lënë në fuqi vendimin e Komisionerit në lidhje me rrëzimin e ankesës së KShH-së ndaj Prokurorisë së Përgjithshme. Me Vendimin nr. 2320, dt. 18.06.2018 Gjykata ka vendosur rrëzimin e Kërkesë-padisë së DSIK për shfuqizimin e Vendimit nr. 04, dt. 05.02.2018 të Komisionerit, ndërsa me Vendimin nr. 2234, datë 11.06.2018 Gjykata ka rrëzuar Kërkesë-padinë e KShH-së për ekzekutimin e Vendimit nr. 05, dt. 05.02.2018 të Komisionerit në çështjen ndaj ILDKPKI-së. Ndaj Vendimit nr. 2234 KShH ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ndërsa për Vendimin nr. 2320 nuk kemi dijeni për ndonjë ankim të mundshëm pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nga palët në proces, DSIK apo Komisioneri. Në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Megjithatë, ndjekja e rrugëve ligjore nga KShH për të mundësuar transparencën e këtyre organeve, ndihmoi pozitivisht në këtë drejtim. Në dt. 18.06.2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e Kërkesë-padisë së DSIK duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionerit që i hapte rrugë transparencës për informacionin e kërkuar. Në vijim të këtij vendimi, është pozitiv fakti që DSIK ju drejtua KShH-së me shkresë për dhënien e informacionit, duke pranuar të zbatojë vendimin e Komisionerit dhe të Gjykatës Administrative.

¹⁴⁴DSIK ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ndaj Vendimit nr. 04, dt.05.02.2018 të Komisionerit, ku KShH ka ndërhyrë si Person i Tretë në procesin administrativ. Për ILDKPKI, KShH ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatë për mos zbatim të Vendimit nr. 05, dt. 05.02.2018 të Komisionerit.